



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,  
TË MBAJTUR MË 3.02.2017**

**SHKURT**  
**2017**

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Albulena Haxhiju

KRYETARJA: Përshëndetje për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Po ashtu edhe për përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile që janë përgjegjgur pozitivisht ftesës për këtë tryezë.

Së pari më lejoni të ju informojë ndonëse edhe në ftesë e keni pasur të njohur Komisioni për Legjislacion në bashkëpunim edhe me Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike por po ashtu kemi bërë përpjekje që këtë bashkëpunim ta zgjerojmë edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Kemi ndërmarrë këtë iniciativë për këtë tryezë që qëllimi i kësaj tryeze ka të bëjë me shqetësimet e vazhdueshme për mos transparencën dhe mos auditimin e financave të subjekteve politike.

Gjatë kësaj kohe është diskutuar goxha shumë kjo çështje dhe si Komision për Legjislacion kemi parë të rëndësishme organizimin e një tryeze të tillë në mënyrë që ta shikojmë ose t'i gjejmë modalitetet se si është më së mirë që të bëhet kjo çështje.

Sa do që ekziston një infrastrukturë solide ligjore si në nivel të legjislacionit primarë por edhe në atë sekondar për financimin dhe kontrollin e shpenzimeve të subjekteve politike. Financimi i partive politike dhe mbikëqyrja e shpenzimeve të tyre mbetet një aspekt tërësisht jo transparent.

Çështja e kontrollit të jashtëm përmes auditimit si një problematik e vazhdueshme ka devijuar nga auditim sa për sy e faqe në të kaluarën në mos auditim.

Raportet e partive politike për zgjedhjet e fundit lokale 2013 dhe ato parlamentare të vitit 2014 lidhur me financimin dhe shpenzimet e tyre ende nuk janë audituar nga komisioni kompetent brenda Kuvendit të Kosovës ashtu siç e parasheh rregullimi aktual.

Madje partitë politike as nuk kanë publikuar raportet financiare të cilave së fundit Zyra e BE-së ju kërkoj direkt që t'i publikojnë ato.

Do ta kemi të qartë se auditimi i raporteve nuk do të reflektonte financimin e vërtetë të shpenzimeve të vërteta të partive politike.

E vetmja mënyrë për tu zbardhur skemën e financimit të partive politike është hetimi real dhe i paanshëm i mënyrës se si shpërndahet paraja publike nga tenderët, kontratat e mëdha të investimeve publike, subvencionet, punësimet në sferën publike e deri tek dhënia e licencave të ndryshme për operatorë të ndryshëm.

Me që jam ose i përkas Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” më duhet me theksua faktin se ne si subjekt politik kemi qenë të hapur dhe transparent jo vetëm në raport me institucionet përgjegjëse por edhe me publikun e gjerë për mënyrën e financimit duke ftuar publikisht mbështetjen financiare për aktivitetet tona por edhe duke ofruar mundësinë ligjore për kontribut në xhironlogarinë tonë por edhe duke i publikuar financat për secilin vit.

Duhet ta kemi të qartë se kjo praktikë e auditimit ku një komision i Kuvendit të Kosovës përzgjedh auditor privatë .. ka dështuar sot jemi dëshmitarë të asaj që kjo mënyrë ka dështuar por edhe nuk garanton një proces të drejtë të auditimit dhe në disa pika parqet konflikt interesi, domethënë Kuvendi vendos ose një komision kompetent i Kuvendit vendos për një auditor privatë për t’i kontrollua financat e vetë përfaqësuesve që bëjnë pjesë në përzgjedhjen e këtij auditori.

Prandaj, është e domosdoshme që edhe auditimi i financimit dhe shpenzimeve të subjekteve politike të bëhet në një mënyrë ndryshe.

Unë jam e mendimit që këtë nuk duhet ta bëjë as Kuvendi e as një operator privat.

Më duhet me nda me juve një praktikë të mirë që e kemi marrë si Komision për Legjislacion në vizitën që e kemi pasur në Letoni domethënë atje institucioni kompetent i cili bënë pasqyrimin e financave të subjekteve politike por po ashtu edhe auditimin e këtyre financave ka qenë Agjencioni Kundër Korrupsionit, domethënë emërtohet ndryshe por që e bënë Agjencioni Kundër Korrupsionit.

Për këtë arsye e kemi ftuar edhe drejtorin e Agjencionit Kundër Korrupsionit sepse kemi qenë bashkë në atë vizitë të cilën na ka mundësua NDP. Pasi që jemi kthyer këtu me kërkesë të NDP është kërkuar nga Komisioni për Legjislacion që të organizojmë një tryezë të tillë dhe natyrisht ne kemi shprehur vullnetin që ta diskutojmë edhe këtë mënyrë, nuk po them që është ndoshta më e mira por patjetër që rregullimi aktual duhet të ndryshohet sepse ka dështuar dhe nuk ka funksionuar siç duhet.

Pra, unë po e hapë debatin, mirëpo fillimisht po doja t'ia kaloja fjalën kryetarëve të komisioneve për Buxhet edhe atij për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mënyrë që t'i thonë qëndrimet e tyre.

Ne jemi të vetëdijshëm që Komisioni kompetent funksional për ndryshimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike është Komisioni për Buxhet dhe Financa. Natyrisht në qoftë se në fund do të del nevoja e ndryshimit të këtij ligji kompetencën do ta ketë Komisioni Funksional por qëllimi kësaj tryeze është marrja e përvojave më të mira se si mund ta adresojmë këtë çështje e cila na ka paraqit problem në praktikë dhe ka pasur shqetësime të shumta qoftë vendore qoftë ndërkombëtare në lidhje me këtë tematikë.

Po ja kaloj fjalën zotit Osmani dhe pastaj kalojmë te zoti Topalli.

NASER OSMANI: Faleminderit, deputete!

Përshëndetje për të gjithë,

Është një çështje domethënë që kemi diskutuar edhe më herët dhe nuk është ky takim i parë lidhur me këtë temë.

Takimin e parë e kemi pasur kohë më parë me kryetarin e Kuvendit dhe me kryetarët e disa komisioneve me zonjën Apostollova shefen e Zyrës së BE-së për Kosovë të cilën e kemi diskutuar këtë çështje.

Pastaj takimi tjetër ka pasua me këshilltarët e shefes së Zyrës së BE-së dhe Komisionin për buxhet dhe Financa dhe kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare që e kemi diskutua hollësisht Ligjin në fjalë.

Ta them të drejtën ky ligj është bërë me kërkesën dhe insistimin atëherë të autoriteteve të Bashkimit Evropian.

Për me qenë më i kjartë me ju, këtë ligj e kanë bërë ata vetë dhe ne e kemi procedua ashtu qysh e kanë prua ata.

Në praktikë na ka dal problemi, problemi ka dal me nenin 19 që ka të bëjë me sigurimin e vetë auditorëve të licencuar që do të bëjnë auditimin e subjekteve politike dhe duke ditur rrethanat në Kosovë që një numër i tillë është vështirë me u sigurua të auditorëve të licencuar ne kemi ardhur në këto telashe.

E kemi bisedua mundësinë se si të shkojmë në faza. Faza e parë kemi konsideruar që do të ishte më e mira që ne të bëjmë përpjekje që partitë politike ta bëjnë më

transparente shënime të tyre, raportet e tyre financiare edhe si po duket kjo vetëm ka një rezultat modest në këtë drejtim.

Tek e fundit edhe Ligji në fjalë e parasheh një gjë të tillë. Po e vërteta është që pasqyrat financiare nuk do të duhej të pasqyroheshin në faqet zyrtare të partive politike se nuk janë të audituara dhe këtu nuk ka të drejtë të lavdërohet asnjë subjekt që këtë gjë e ka bërë sepse janë shënime jo të audituara.

Prandaj, e konsideroj të nevojshme këtë diskutim po ky diskutim gjithnjë për me bërë zgjedhje dhe jo me politizua se është një obligim ligjor dhe një e drejtë për prezantimin apo publikimin e të gjitha shpenzimeve të cilat i bëjnë subjektet politike.

Është çështje tjetër prejardhja e mjeteve, janë organet të tjera që hetojnë prejardhjen e mjeteve dhe nuk është çështje me të cilën deputetët do të duhej të merreshin apo të kenë dyshime të kanë dilemat e veta apo dyshimet se nga vijnë parat, parat janë të përcaktuara me ligj sa epen, qysh epen, burimet e tyre, publikimi i tyre sikur nuk është e jona që të themi vijnë prej kësaj prej kësaj prej kësaj janë organet hetuese që e kryejnë atë punë.

E jona është që të bëjmë një ligj më të mirë më funksional në kuptimin e asaj që subjektet politike të kryejnë detyrimet e tyre ligjore dhe kjo është vetëm nëse ne e bëjmë ndryshimin e ligjit.

Ne si Komision për Buxhet dhe Financa e kemi shti në planin e punës që të bëjmë monitorimin e zbatimit të Ligjit për subjektet politike domethënë e kemi në plan të punës dhe po ashtu i kemi nda 120 mijë euro për të provuar edhe një herë të sigurojmë auditimin e subjekteve politike domethënë i kemi pasur 60 e kemi rritë në 120 mijë euro dhe konsiderojmë që kjo shumë do të duhej të ishte e mjaftueshme për të bërë auditimin e subjekteve politike që janë parlamentare se nuk mundemi të gjithëve po të paktën këtyre që janë parlamentare që na obligon edhe ligji dhe do të provojmë.

Gjatë bisedave të cilat i kemi bërë dhe të cilat kryesisht jemi pajtuar që patjetër duhet të bëhet një ndryshim që të jetë neni 19 domethënë kontrolli financiar më praktik është edhe ideja që kjo kompetencë t'i kaloj KQZ-së që KQZ-ja të jetë organi i cili bënë auditimin apo siguron auditimin e subjekteve politike jo Kuvendi, nuk do të ishte domethënë në rregull që Administrata e Kuvendit të ngarkohet me këtë çështje kur ne kemi një organ ligjor i cili merret me të gjitha punët, veprimtaritë e

subjekteve politike edhe kjo çështje është dashtë të kaloj në kompetencën e KQZ-së.

Si Komision për Buxhet dhe Financa edhe në marrëveshje që kemi bë me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian jemi pajtua që ta bëjmë ligjin edhe që ne edhe me kryetarin e Kuvendit kishim një disponim që t'i hymi shpejtë ta bëjmë se ashtu ishte edhe diskutimi që rrjedhi me zonjën Apostollova ta bëjmë shumë shpejtë pastaj gjatë bisedave erdhëm në përfundim që si fazë të shkohet me publikimin të paktën partitë politike mujnë me i publikua ato raporte të cilat i kanë dorëzua në KQZ me qenë se ne e dimë që KQZ-ja i bënë publike, po një lëvizje që edhe subjektet politike në faqet e tyre zyrtare që ato raporte të njëjta mujnë me i publikua edhe asgjë tjetër edhe të shohim që dal në dalë të ulemi bashkërisht ta bëjmë ndryshimin e ligjit tash edhe me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike sidomos këtë nenin 19 që ka të bëjë me kontrollin financiar dhe unë konsideroj që duhet patjetër të ndryshohet.

Kjo ishte sa për hyrje dhe shpresoj që edhe qëllimi i kryetares së komisionit për Legjislacion është shumë i sinqertë dhe është shumë i mirë edhe në këtë drejtim ka me kontribuu që kjo të avancohet edhe më tutje.

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Osmani!

Nëse ke mundësi mikrofonin, po ja kaloj fjalën zotit Topalli kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

**FATON TOPALLI:** Faleminderit!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile,

Unë do të raportoj shkurt për punën që ka bërë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike deri më tani lidhur me auditimin e financave të partive politike.

Ky Komision për vitit 2014 ka vazhduar pastaj në vitin 2015, në vitin 2016 dhe tash përsëri në vitin 2017.

Ka diskutuar vazhdimisht këtë çështje dhe ka autorizuar Administratën e Kuvendit të ndërmarre hapat e nevojshëm për të kërkuar dhe për t'i gjetur auditorët të cilët do t'i auditonin financat e subjekteve politike.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2014 ka zhvilluar dy procedura dhe procedurat e tenderimit janë anuluar në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Këto oferta janë zhvilluar më datën 25 mars 2014 dhe 22 prill 2015.

Në vitin 2015 është zhvilluar një procedurë më 31 mars për auditimin e raportit vjetor financiar dhe raportit të deklarimit financiar të fushatave të subjekteve politike për vitin 2013 dhe 2014, procedura është anuluar, në vitin 2016 është zhvilluar përsëri të njëjtat procedura.

Pra, ka pasur vazhdimisht nga ana e Komisionit përpjekje që kjo çështje të vije në rrugë të drejtë.

Komisioni ka qenë i interesuar dhe ka kryer të gjitha obligimet që i takojnë si Komision, edhe në kërkesën e fundit gjithashtu kemi qenë unik që kjo çështje të zhvillohet sa më shpejtë.

Për fund do të them dhe ky nuk është qëndrim i Komisionit që në fund të fundit auditimi i financave të partive politike ka treguar që ka munguar vullneti politik për ta bërë auditimin për arsye se u bënë katër vite dhe në qoftë sa ka pasur mangësi në ligj ka pasur kohë të mjaftueshme për ta rregulluar dhe për ta ndryshuar këtë ligj dhe për ndryshimin po flitet vetëm tani pas presionit që Bashkimi Evropian ua bërë partive në pushtet.

Për mendimin tim në një farë mënyre auditimi i financave të partive politike u bë me qëllim për mua është edhe një lloj bojkoti dhe nuk është e drejtë e imja të paragjykoj pse mendoj që vetë fakti që shumica parlamentare për katër vite me radhë nuk ka arritur të gjejë një zgjidhje rreth kësaj çështje tregon mungesën e vullnetit politikë dhe pa përgjegjësinë karshi qytetarëve.

Jam i vetëdijshëm që KQZ-ja nuk ka pasur mundësi të publikoj raportet për arsye se që ato të publikohen duhet fillimisht të auditohen.

Ne kemi mbajtur në dhjetor të vitit të kaluar një javë të tërë lidhur me çështjen e financimit të subjekteve politike dhe është treguar bukur shumë gatishmëri për t'i publikuar ato pas presioneve të caktuara, megjithatë është dashtë prapë shumë kohë me arsyetime të ndryshme për t'i publikuar.

E tha edhe Albulena Haxhiu, ne si subjekt politik i kemi publikua financat tona publike dhe ligji nuk na e ndalon, përkundrazi standardet e auditimit kërkojnë që financat e partive politike të publikohen.

Ne i kemi publikua në faqet tonë zyrtare dhe ia kemi afruar auditorit gjeneral kur po them auditori gjeneral po them qytetarëve.

Kjo është vërtetë një aspekt i rëndësishëm i transparencës sepse ato që i publikojmë kemi mundësi t'i tërheqim, pra qytetari ka mundësi të krahasoj me ato që kemi deklaruar me mënyrën dhe mbi të cilat ne i kemi marrë si qytetarë, pra kemi qenë deri në fund transparent sa i përket kësaj çështje.

Albulena i tha propozimet që mund të diskutohen këtu se kush do të duhet të bëjë auditimin e financave të partive politike.

Po shpresoj që tashmë pas presioneve edhe të Bashkimit Evropian që ky proces do të filloj dhe ne do të gjejmë një zgjidhje të përbashkët. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, zoti Topalli!

Po vazhdojmë me të pranishmit, vetëm dua me ju informua që nuk ka një renditje të folësve. Unë do t'i rëndës ashtu siç edhe kërkohet fjala. Zonja Halimi, që është nënkryetare e Komisionit për Legjislacion, e ka kërkuar fjalën, pastaj ju kisha ftuar edhe të tjerëve që të kontribuoni në këtë debat në mënyrë që ta gjejmë një zgjidhje sa më të mirë.

**SELVIJE HALIMI:** Faleminderit, zonja Haxhiu!

Përshëndetje për kryetarët e dy komisioneve të Kuvendit, zotin Osmani dhe zotin topalli,

Përshëndetje për drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe të gjithë të pranishmit tjerë kolegë deputetë dhe shoqërinë civile, vendore dhe ndërkombëtare.

Realisht secili që mendon apo secili nga ne që mund edhe të paragjykoj se një ikje e një përgjegjësie ligjore qoftë brenda subjekteve politike që janë jashtë institucioneve qoftë edhe brenda subjekteve politike që janë në institucione është një mashtrim i tyre sepse herdo kurë secili do të përgjigjet dhe do t'i nënshtrohet një kontrolli qoftë ai financiar apo veprimtarie tjetër.

Kështu që në këtë kontest mendoj se mirë që kemi marrë iniciativat të tilla dhe mirë edhe për iniciativën që është marr në tremujorin e fundit të vitit 2016 nga kryetari i Kuvendit, zonja Apostollova dhe të ftuar ishin tre komisionet e përhershme faktikisht dy komisionet e përhershme dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që në mungesë të kryetares kam prezantuar vetëm në atë komision.



Mirëpo, para se të flas dua te bej një elaborim të përfundimeve të atij debati unë dua të them një që kushdo në Kosovë që tenton t'i ik përgjegjesisë ligjore, kushdo që mund të lavdërohet se jam pastër me ligjin, ne jemi një vend i vogël një popullatë e vogël, një shtet në ndërtim e sipër dhe para se të arrijmë në konkludimet apo në përfundimet se kush i pari bëri këtë apo atë qoftë në auditim, qoftë në transparencë, qoftë në denoncime për vepra të ndryshme në këtë rast për shmangie nga zbatimi i ligjit lidhur me financat publike të partive politike. Mendoj që atributet qoftë për mirë qoftë për keq na i bjenë të gjithëve.

Në qoftë se i atribuohemi sovranit popull qytetarët tanë marrinë atë çfarë ne themi jo çfarë ne bëjmë, sepse zërat për të treguar çfarë ne bëjmë dhe çfarë themi janë të ndryshëm dhe kam perceptime nganjëherë nga emocionet momentale të cilat dalin nga ne pa dallim a jemi pozitivë apo opozitivë, pa dallim a jemi shoqëri civile pa anime politike apo me anime politike dhe pavarësisht asaj se a jemi përfaqësues të faktorit ndërkombëtarë.

Vetëm mekanizma të caktuar të faktorit ndërkombëtarë gjegjësisht të BE-së në deklaratimet e tyre të shkruara thonë, të gjitha praktikrat e BE-së janë të mira por secili vend duhet të marrë edhe mendimin e ekspertëve vendor në mënyrë që në praktikrat e BE-së të mund të marrin edhe elemente autoktone në mënyrë që problemet të gjejnë zgjidhje më të shpejtë. Për këtë gjë që e them mbajë përgjegjësi sepse kam lexuar në vetë raportet e tyre dhe po e flas sot.

Në takimin që kemi mbajtur në tremujorin e fundit të vitit 2016 ku ishte zonja Apostollova, kryetari Osmani, zoti Sadriu, unë dhe disa anëtarë të komisioneve tjera të cilët edhe nga kureshtja kanë dëshiruar të marrin pjesë të gjithë së bashku u dakordua që mos auditimi i financave të partive politike nuk shkon në interes të askujt por shkon në dëm të të gjithëve si shoqëri sepse këta njerëz kjo strukturë e organizuar brenda subjekteve politike me marrjen e votës nga qytetarët hyn në institucione dhe po qe se si parti politike jemi të padisiplinuar në raport me ligjin domosdoshmërisht që ajo jo disiplinë brenda partive në një masë më të vogël do të bartet edhe si jo disiplinë në institucione.

Prandaj, duhet të mos hezitojmë dhe të gjejmë zgjidhje sa më të shpejtë që të bëhet auditimi i partive politike.

Përfundimet e komisionit ishin pas diskutimit gati dy orësh që Komisioni për Buxhet të marrë iniciativën të bëjë plotësim ndryshimin e ligjit në mënyrë që të mos jesisim peng i procedurave ligjore dhe të mos arrihet auditimi i partive politike.

Po në atë takim nga kryetari i komisionit, më fal që duhet të ju citoj me që edhe jeni këtu u tregua fakti i hartimit të ligjit që tash është në fuqi për auditimin e partive politike gjegjësisht për financat e subjekteve politike, pikërisht çështja që ka të bëjë me rregullimin e auditimit ku ne si vendor kemi insistuar në fakt unë jo por Komisioni përkatës ka insistuar që ligjit të rregullohet ndryshe dhe me insistimin e përfaqësuesve të BE-së është ajo çfarë ligji është sot në fuqi dhe kanë dalë probleme në zbatim.

Ajo çka ne kemi gabuar si institucione është që pas dy dështimeve të përzgjedhjes së auditorëve nuk kemi marrë vetë iniciativën për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit.

Dhe sipas gjithnjë sipas informacioneve Komisioni përveç që kanë diskutuar më pas dhe kanë bërë grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit me sa di unë kanë mbajtur edhe disa takime e përfaqësues të BE-së në mënyrë që të xhindet zgjidhja më e mirë e mundshme për auditimin e partive politike.

Në të njëjtën kohë po në atë takim kryetari i Kuvendit zoti Veslei patë kërkuar nga zonja Aposollova në qoftë se na duket se është procedurë e gjatë çështja e plotësim ndryshimit të ligjeve mund faktikisht edhe ka kërkuar ndihmë nga ajo që të angazhojmë një auditor ndërkombëtarë i cili do të auditor partitë politike dhe deri më tash nuk kemi përgjigje se a ka mundësi që të angazhohet një auditor ndërkombëtarë për auditimin e partive politike por i kemi iniciativat e komisioni përkatës Komisionit të Buxhetit që të bëjë zgjidhjen më të mirë të mundshme edhe më të shpejtë të mundshme në mënyrë që të bëhet auditimi i partive politike.

Sipas ligjeve që sot janë në Kosovë çdo gjë që nuk është e audituar dhe publikohet nuk do të thotë që është ashtu çfarë është, kjo është njësoj sikur për të gjithë të akuzuarit për vepra të ndryshme derisa nuk vërtetohet fajësia apo ... ata janë të pafajshëm janë gjithnjë të dyshuar.

Kështu që pasqyrat financiare të partive politike gjithmonë kanë qenë të publikuara në KQZ për të gjitha subjektet por nuk kanë qenë të publikuara nga të gjitha subjektet në WEB faqet e tyre zyrtare si subjekte politike përjashtimisht ka pasur të publikuara Lëvizja.

Si do që të jetë, pas takimeve të fundit të gjitha subjektet politike e kanë pa të arsyeshme që t'i publikojnë edhe ato vetë dhe në një pyetje që unë personalisht e kam bërë në administratën e partisë time çka keni bërë me ato listat pse nuk po i

publikoni ose ato pasqyra, përgjigjen e kam marrë janë të gjitha në KQZ ne po presim auditimin t'i publikojmë të audituara në WEB faqen tonë sido që të jetë është kërkuar nga kryetari i Kuvendit që të bëhen publike edhe të paaudituar dhe tashmë gjithnjë sipas informacioneve po thaj se të gjitha partitë politike kanë publikuar pasqyrat financiare si të tilla çfarë i qet administrata e partive politike por nuk janë të audituara dhe secili ka të drejtë të besoj në vërtetësinë apo pavërtetësinë e tyre deri sa nuk është një raport fundit.

Kështu që unë mendoj që takimi i sotëm me gjithë atë ka një rëndësi të veçantë sepse po sensibilizohet çështja dhe secili akter që është brenda këtij takimi po edhe ata jashtë që do të na dëgjojnë dhe përcjellin punën tonë do të japin kontributin e tyre nga kundërshtimi i tyre dhe nga përgjegjësia e tyre ligjore që sa më shpejtë të bëjmë zgjidhjen përmes plotësim ndryshimit të Ligjit për financimin e subjekteve politike me qëllim që të bëhet auditimi i partive politike.

Derisa nuk kemi një rezultat të auditimit, derisa nuk kemi denoncime të faktuara se financimi i partive politike bëhet jashtë ligjshëm apo në forma të ndryshme çdo diskutim i tillë pa përfundime të cilat i ceka ja humb rëndësinë dhe vlerën këtij takimi.

Kështu që edhe një herë po e potencoj që auditimi duhet të bëhet domosdoshmërisht dhe jo atë vetëm për vitet e fundit por për të gjitha vitet e mbetura aq sa mund të nxjerrin organet kompetente gjegjësisht auditorët vërtetësinë e pasqyrave financiare.

Dhe kjo nuk guxon që të na ndodhë vitet e ardhshme që të na kalojnë vitet pa u bërë auditimit, kur e them këtë kam edhe një dilemë.

Auditimi po, auditimi po bëhet edhe brenda institucioneve. Të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës janë subjekte të cilat qeverisin qoftë nivelet lokale qoftë qendrore.

Gjithherë auditori jep rekomandime qoftë për financat publike qoftë për zbatimin e ligjeve tjera të atij të shërbimi civil, kontratave të punës e të ngjashme. A thua jemi të gjithë ne ata të cilët me pikëpikëri i zbatojmë rekomandimet e auditorit, të gjithë e dimë edhe ju sikur unë që nuk jemi sepse janë të shumta rastet që ne vetë kudo që jemi në institucione edhe rekomandimeve të auditorit përpiqemi të bëjmë shmangie, sa na zgjatë përpjekja për të bërë shmangie është çështje tjetër por në fillim përpiqemi të bëjmë shmangie nga rekomandimet finale të auditorëve, marrë edhe si rast auditimin apo raportin e auditimit të fundit i cili u debatua edhe në

Kuvendin e Kosovës, pa të lëshohemi në nivele lokale dhe nivele qendrore në të gjitha institucionet dhe të shohim se sa e kanë marrë me seriozitet ato rekomandime që t'i zbatojnë institucionet. Unë personalisht jam e pakënaqur, mirëpo edhe përkundër faktit që rekomandimet nuk merren shumë seriozisht ato duhet të ndodhin sepse duke e sensibilizuar çështjen secili do të vetëdisohen më tepër si pjesë e administratës publike në Kosovë dhe secili do të jetë më i përgjegjshëm në mënyrë që të zbatoj të gjitha rekomandimet dhe parimet mbi bazën e të cilave duhet të funksionon ky institucion. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, zonja Halimi!

Para se me kalua edhe te përfaqësueset i ftoj që të përgatiten për fjalë se ka përfaqësues edhe të Zyrës së Auditorit, KQZ-së, Agjencionit Kundër Korrupsionit, po ja kaloj zonjës Pantina, pastaj zoti Havolli, zonja Pantina dhe zoti Havolli, veç ju kisha lutë më shkurt mos me zgjatë për shkak se pastaj secili ka obligime të tjera dhe po mbesim këtu. Pas zotit Havolli zonja Emini, kryetare e Komisionit për Integritet Evropian.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, Albulena!

Do të mundohem të jem shumë e shkurtë, në fakt disa prej çështjeve që desha me i përmend veç i tha Selvija, ndoshta në një mënyrë tjetër po e tha, ajo çka dua të theksoj prej këtij debati është dy çështje pozitive që po shoh: e para, po krijohet, po shpresoj se tani e tutje do të krijohet praktikë e mirë që diskutimet edhe për projektligje të dalin edhe jashtë seancës plenare ku atje natyrisht është vendi kryesor ku diskutohen dhe në fund votohet.

Por, mendoj që ka hapësirë të mjaftueshme dhe është më se e domosdoshme që diskutimet dhe debatet të hapen duke iu dhënë mundësi edhe institucioneve tjera, cila qoftë direkt qoftë tërthorazi në punën e tyre kanë të bëjnë me projektligjin në përgjithësi për momentin edhe Projektligjin e financave të partive politike, por për t'ju dhënë mundësi edhe publikut të gjerë që të japin kontributin, vërejtjet e tyre gjë që deri tash nuk them se nuk ka ndodhur asnjëherë, por është si praktikë e cunguar, e munguar kështu që mendoj që një formë e tillë e diskutimit duhet të zgjerohet veçanërisht në formatet e tilla ku më shumë se një komision është i përfshirë në diskutim.

Në fakt ajo pse desha të flas, ajo çka më shtyri është fjala e zotit Osmani kur tha që ligji është proceduar ashtu siç ka ardhur, domethënë është plotësisht i shkruar nga Bashkimi Evropian, nga komisioni. Me një fjalë nga dikush që nuk është në Kuvend, jo nga një trup, një organizëm që do të thotë, mirë po kjo nuk është hera e parë që po ndodh që një projektligj pothuajse në tërësi të hartohet nga dikush jashtë

institucioneve të Kosovës. Kjo nuk është gjë e keqe, ne kemi nevojë të mësojmë nga praktikat e vendeve të ndryshme ashtu siç mendoj se ka edhe praktika të mira tonat të Kosovës, edhe të institucioneve të cilat mund të barten tek shtetet tjera e ata do të mund të mësonin edhe nga ne.

Por, ajo çka për mua me përjashtime, por ka qenë praktikë jo e mirë është një lloj ngurimi që të bëhen ndryshime ose tendenca për tu marrë si të mirëqena, si të tilla çka do që vjen nga dikush ndërkombëtar. Unë mendoj se pastaj kjo ka krijuar pengesa akoma më shumë kur ka ardhur puna tek zbatimi i tyre dhe siç po duket ky ligj me nene të caktuara është njëri nga shembujt. Kështu që mendoj që ne kur ulemi të shkruajmë ligje natyrisht që duhet t'i marrim parasysh vërejtjet, sugjerimet, propozimet që vijnë edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, cilado qofshin organizma ato, por në rend të parë duhet të kemi parasysh se cilat janë nevojat, kërkesat dhe cila është kultura më e mirë e vendit tonë e cila do ta bënte at ligj të zbatueshëm.

Fundi i fundit unë mendoj që është më mirë të kritikohemi pse nuk e kemi rregulluar një fushë siç duhet se sa të kritikohemi se nuk po e zbatojmë. Nuk është problemi tek ne se nuk kemi ligje, ka fusha të cilat nuk janë të mbuluara me legjislacion ose nëse ligjet nuk i kemi të mira. Vërejtjet më të mëdha ne i marrim se nuk po i zbatojmë ato ligje dhe një nga arsyet pse nuk po i zbatojmë si duhet ato ligje është se kur po i shkruajmë po duam të jenë të mira, të tingëllojnë bukur, të tingëllojnë në harmoni me këtë standard me atë standard e që në praktikë po janë plotësisht të pazbatueshme.

Tash pse për mua është shumë më e rëndësishme se sa një sërë ligje tjera mënyra edhe e financimit, por edhe mënyra e shpenzimit të parasë dhe të raportimit nga partitë politike. Pjesërisht e tha edhe Selvija kështu që s'po dua ta përsëris por është për faktin se forma, standardet, praktikat, të cilat partitë i praktikojnë në qeverisjen e tyre të brendshme është një tregues se si do të qeverisin pastaj ato dhe kur them "qeverisin" e kam fjalën edhe për mënyrën e shpenzimit dhe raportimit të financave edhe nesër kur ato pastaj i drejtojnë institucionet dhe kjo tashmë është dëshmuar praktikisht.

Domethënë, vërejtjet ne kemi shumë vërejtje që i dimë vetë që i themi vetë për mënyrën si drejtohen, si funksionojnë institucionet tona edhe karshi harxhimit të parasë publike dhe bërjes së tyre transparente dhe tashmë po e kuptojmë edhe se nga është burimi, se dikush që deri dje nuk ka dit, nuk ka mundur, nuk ka dashur, s'ka pas vullnet për të qeverisur me një institucion që është shumë më i vogël siç është subjekti politik, një vullnet të tillë nuk e shoh se do ta ketë pastaj nesër kur ta

merr edhe përgjegjësinë publike, sepse fundi i fundit edhe partia politike është një lloj institucioni publik edhe drejtimi i saj duhet të ketë edhe përgjegjësi publike dhe për fund ajo çka do të doja të thoja edhe pse u tha, edhe nga pothuajse nga të gjithë parafolësit është se ne nuk duhet të veprojmë në këtë rast edhe për ndryshim të projektligjit vetëm kur një presion i tillë vjen nga kryesisht nga Organizata Ndërkombëtare.

Një shqetësim sidomos për financimin e partive politike është ngritur me dhjetëra herë nga organizatat vendore, por kur ato ndonëse e kanë bërë goxha shumë zhurmë nuk kanë arrit që atë ta bëjnë temë të debateve, diskutimeve e lëre më që filloji iniciativa për ndryshim dhe i vetmi reagim serioz për dhe gatishmëri për të bërë diçka në këtë fushë ka ardhur kur presioni është bërë ose është shtuar nga Bashkimi Evropian. Kështu që një praktikë që ndoshta tani e tutje duhet ndryshuar është që të reagojmë ndaj për mua është një formë presioni kur ajo diskutohet vazhdimisht brenda javës, sugjerimi është një nga mënyrat e presionit. Kështu që edhe njëherë do të ishte mirë po them që të reagonim ndaj sugjerimeve, pra nëse nuk doni ta përdorni fjalën “presion” që vijnë nga organizatat vendore, nga qytetarët para se të vijë puna që ne të reagojmë ndaj sugjerimeve të Bashkësisë Ndërkombëtare. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, zonja Pantina! Fjalën e ka zoti Havolli që është drejtor i Agjencionit Kundër Korrupsionit në qoftë se keni mundësi zoti Havolli përbrenda diskutimit tënd të na njoftosh, unë jam e vetëdijshme që Agjensioni Kundër Korrupsionit aktualisht nuk ka kapacitete për ta bërë këtë çështje, prej përvojës dhe prej atyre çfarë është raportuar në komision duke ditur që jemi komision mbikëqyrës i Agjencionit Kundër Korrupsionit. Por, nëse i shtojmë kapacitetet këtij agjencioni, në qoftë se atje domethënë dërgohen njerëz të profilizuar për këtë punë, atëherë sa ka mundësi Agjenconi Kundër Korrupsionit ta bartë mbi vete këtë kompetencë.

Domethënë pasqyrimin dhe auditimin e financave të subjekteve politike.

**SHAIP HAVOLLI:** E nderuara kryetare, zonja Haxhiu!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm media dhe shoqëria civile.

Siç e dini Agjencioni bazuar në Ligjin mbi financimin e partive politike neni 19 e ka mandatin t'i kontrollojë të gjitha pasqyrat financiare pasi të jenë të audituara.

Bazuar në informacionin që kam marrë tash nga zyrtarët tjerë, sepse siç e dini unë jam i ri në këtë agjencion, deri më tash asnjë raport i auditimit nuk ka ardhur nga

KQZ-ja në agjenci, domethënë i ka ... vite që asnjë raport nuk është auditua, si dhe Agjencioni s'ka praktikë të auditimit të këtyre raporteve. Megjithatë, për ligjin aktual i cili është agjencioni ka kapacitete, për ligjin aktual në rast ... plotësohet ky ligj bazuar në disa praktika që i kemi marrë nga vizita studimore në Lituani, atëherë agjencioni duhet të ngrit kapacitete të reja dhe patjetër duhet të kompletohet me staf në fushën e auditimit dhe ... ma merr menja që deri më tash nuk ka pas ndonjë vullnet, ndonjë gatishmëri nga ana e vetë subjekteve politike që të bëhet ky auditim dhe të ketë një transparencë. Po, besoj që është koha e fundit që të rregullohet diçka në këtë drejtim, jo veç të merremi me të ... akuzohet njëri-tjetrin, s'po dua të përzihem në çështje të juaja politike, por ka ndodh çka ka ndodh besoj që tash e tutje të veprohet, të mos ketë gjithë retorikë hajde edhe këtë vit edhe tjetrin vit të bartet, por të marrim praktika prej vendeve të ndryshme.

E falënderoj edhe njëherë UNDP për organizimin e këtij takimi ka qenë jashtëzakonisht e mirë, duhet të marrim disa praktika jo komplet ligjin e tyre, por t'ju përshtatemi ligjeve tona vendore ku aty bazuar në këtë ligjin, bazuar në përvojën që kemi marrë dy ditore ishte jashtëzakonisht një ligj shumë i mirë me të cilin ishte edhe shumë transparent, pasi të auditojke agjencia këto raporte i bënte publike për gjithë publikun.

Një falënderim duhet dhënë edhe shoqërisë civile edhe që vazhdimisht ka ngrit zërin sa i përket çështjes së auditimit të partive politike. Besoj që agjencia për gjithë ato çka i ofron në mënyrë ligjore agjencisë do të jetë e gatshme t'i zbatojë dhe t'i bëjë këto, t'i auditojë këto raporte. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, zoti Havolli! Vetëm edhe një qartësim, sepse në kohën kur diskutonte Shqipja në lidhje me nenin 19, kontrollin financiar mua më erdh një informacion që propozimi ka qenë nga EULEX-i për nenin 19, të ligjit aktual. Vetëm desha ta qartësoj në qoftë se dikush nga Bashkimi Evropian, përfaqësuesit e zyrës së BE-së dëshiron ta marr fjalën. Blerta a e deshte fjalën? Blerta, pastaj Njomza Emini që është kryetare e komisionit për

**BLERTA BEJTULLAHU:** Po, vetëm shkurt domethënë propozimi për nenin 19, ka qenë i rekomanduar nga misioni i BE-së për sundimin e ligjit në vitin 2012 ose 2013 atëherë. Edhe kjo ka ardhur domethënë për shkak të mos ndoshta auditimit të tërësishëm të raporteve financiare, atëherë të partive politike që kanë ndodhur domethënë ka qenë në atë kohë kompetencë e KQZ-së.

Çka dua të them ne si BE, prapëseprapë mendojmë që neni 19 nuk është problematik, problem ka qenë domethënë buxheti i alokuar për ta bërë, për ta

implementuar domethënë auditimin e partive politike. Buxheti me vite të tëra domethënë i alokuar, buxheti vjetor për auditim të partive politike po flasim domethënë këtu për secilin vit partitë politike kanë pas miliona domethënë miliona euro në qarkullim, mirëpo buxheti ka qenë shumë i vogël. Për këtë arsye ne mendojmë, mendimi ka qenë që nuk ka pas interesim për të ofertuar, apo interesim nga auditorët për tu marrë me këtë.

**KRYETARJA:** Faleminderit, zonja Bejtullahu! Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Integritet zonja Emini.

**NJOMZA EMINI:** Faleminderit, zonja Haxhiu!

Faleminderit për ftesën,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe ju përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Siç jeni edhe ju të njoftuar me obligimet, të cilat i kemi marrë ne si në kuadër si Kuvend, por edhe si komision në kuadër të agjendës për reforma evropiane e që lidhen me sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies të financave të partive politike. Këto veprime përfshijnë publikimin e raporteve financiare të partive politike, siç e thanë edhe parafolësit e mi, ofrimin e mjeteve adekuate për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike, për zgjedhjen e auditorëve të pavarur se ndryshimi i Ligjit për financimin e partive politike për të ofruar apo për të siguruar llogaridhënie, transparencë dhe zbatimin e sanksioneve efikase.

Edhe si kryetare e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropiane konsideroj që ne tani kemi veprimet nga dokumenti që është lansuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me komisionarin Han dhe mendoj që ne kemi për obligim pavarësisht të sugjerimeve që i marrim nga BE-ja unë mendoj që ne duhet t'i përmbushim obligimet tona edhe si përfaqësues të partive politike, por edhe si kolegë deputetë sa i përket edhe ndryshimit të ligjit që tani po e dimë që ka nevojë dhe është e domosdoshme dhe këtu duhet të jetë fokusi kryesor në këtë debat dhe në këtë diskutim.

Ne si komision do të bëjmë mbikëqyrjen normalisht të veprimeve që tashmë janë të specifikuar të dokumentit të ... dhe ju ofrojmë mbështetje dhe konsideroj që për çka do që është e nevojshme sa i përket edhe këtij dokumenti konsideroni mbështetjen nga Komisioni për Integritet Evropiane dhe duke e ditë që tani më jemi në fazën edhe të fundit sa i përket veprimeve që janë dhe nuk kemi më atë kohën



që të humbasim, duke e ditur edhe nga raportet e gjetura nga Komisioni Evropian, si dhe në veprimet e parapara në agjendën për reforma evropiane.

Mendoj që ne në këtë diskutim apo në këtë debat që konsideroj që është shumë e nevojshme, është vazhdimësi e atyre diskutimeve që ne i kishim edhe në takimin e fundit me zonjën Apostuluva ku ishim dhe u zotuar të gjithë ne kryetarët e komisioneve parlamentare që të marrim masat e nevojshme sa i përket edhe obligimeve tona në rrugën e drejtë të Bashkimit Evropian. Kështu që faleminderit edhe njëherë.

**KRYETARJA:** Faleminderit, zonja Emini! Fjalën e ka përfaqësuesi zoti Mayer a ke kërkuar fjalën? Përfaqësuesi nga UNDP-ja!

(Anglisht)

**KRYETARJA:** Faleminderit, po ashtu edhe për gjithë ndihmën e ofruar gjatë gjithë kësaj kohe. Po mendoj dhe po shpresoj që ky bashkëpunim domethënë do të vazhdojë tutje derisa të zgjidhen çështjet, të cilat edhe po i diskutojmë pse jo edhe për të tjerat që kemi në vazhdimësi probleme.

Fjalën e ka përfaqësuesi i .... zoti Arton Canhasi, pastaj deputeti Abdyl Ymeri, pastaj Grupi për studime juridike dhe deputeti Ali Sadriu.

**ARTON CANHASI:** Faleminderit, Albulenë!

Faleminderit të gjithëve për mundësinë që na keni jap të paktën për të na dëgjuar sa i përket kësaj fushe, sepse jo pak kemi fol deri më tani për këtë fushë mirëpo u bënë 4 vite që fjalët tona nuk po dëgjoen thjeshtë prej institucioneve relevante kështu që unë po filloj diskutimin duke u bazuar në këtë që Kuvendi nuk mundet assesi me u shfajësu për këtë dështim të përzgjedhjes së auditorëve për auditim të partive politike, sepse kjo nuk është kurrjë tjetër pos një çështje teknike, një bartje teknike e kompetencës nga KQZ-ja në Kuvendin e Kosovës.

KQZ-ja është institucion po mendoj politik për shkak se krejt partitë politike janë të përfaqësuara në KQZ, po flas për komisionin jo për pjesën tjetër të administratës edhe Kuvendi gjithashtu është institucion politik ku krejt partitë politike janë të përfaqësuara në Kuvend. Kjo nuk ka ndryshuar kurrjë vetëm është bart një kompetencë prej një institucioni politik prapë në një institucion politik, nuk është që ka ndryshuar shumë. Kështu që mos përzgjedhjen e auditorëve për katër vite me radhë unë personalisht e quaj jo seriozitet të Kuvendit të Kosovës, gjithashtu dështimin më të madh të Kuvendit të Kosovës që ka mundur të ndodh në këtë

histori parlamentare të Kosovës që Kuvendi me dështu me i përzgjedh 10 auditorë për me i auditua financat e partive politike.

Edhe kjo arsye ka dështuar gjithmonë duke u bazuar sepse buxheti që është ndarë ka qenë shumë i vogël. Nuk është që Kuvendi i Kosovës nuk ka mundësi të alokojë buxhet më shumë për me jep auditorëve për me i auditua financat e partive politike. Kjo thjeshtë tregon jo seriozitet dhe një jo vullnet politik për me e zgjedh këtë çështje. unë nuk dua me diskutu shumë për këtë pjesë për shkak se e thashë edhe njëherë kjo është çështje teknike dhe shumë lehtë mundet që të rregullohet, s'ka nevojë të rikthehet kompetenca në KQZ mundet Kuvendi të parashohë buxhet më shumë edhe me e zgjedh këtë çështje ose nëse i hyhet ndryshimit të ligjit kjo kompetencë më së mirë është me u bart te auditori gjeneral është i vetmi institucion i pavarur dhe i specializuar për me bë auditime financiare.

Kështu që kjo kompetencë mundet me u bart te auditori gjeneral jo ndoshta ai me e bë auditimin por auditori gjeneral mundet me i përzgjedh auditorët edhe me i mbikëqyr procesin e auditimit të financave partive politike.

Unë dua të kalojë debatin në një rrafsh tjetër që lidhet me shumë pjesë tjera të ligjit që janë shumë më të rëndësishme me u rishiku që ka të bëjë me mënyrën e financimit të partive politike, me zgjidhjen e modelit që ekziston në botë sa i përket financimit të partive politike që gjithçka duhet të zgjedhim po këtë model që e kemi nuk duhet ta mbajmë për shkak se ky model çfarë është sot ka krijuar një lidhje të rrezikshme klienteliste mes bizneseve që janë pjesë e procesit të marrjes së tenderëve publik dhe dhënies së parave për partitë politike.

Por, janë pikërisht disa biznese që japin pak para për financim të fushatave edhe të funksionimit të partive politike e që pastaj kjo po përkthehet në miliona euro tenderë ... ato parti janë në pushtet ose ruajnë pushtetin ose vijnë në pushtet. E unë po flas disa shifra, në vitin 2010 ka qenë 100 milionë euro vlera e tenderëve që i kanë marrë bizneset që kanë financuar fushatat partive politike deri në vitin 2012 kjo është rrit në 260 milionë euro dhe po t'i rishikojmë edhe këto katër vjet që s'i kemi të audituara ky 260 milionësh me siguri që e ka kaluar edhe vlerën e 500 milionë euro.

Pra, kjo rezulton që është krijuar lidhja klienteliste mes bizneseve dhe partive politike. Unë të jap sot ty pak, edhe ti nesër ki me më jap nesër shumë përmes procesit të tenderimit publik. Unë e konsideroj që kjo çështja më e rëndësishme për me u rregullu në Ligj të financimit të partive politike është me e ndalu mundësinë që bizneset që janë pjesë e procesit të tenderimit publik me mujt me i jap para

partive politike ose nëse partitë e biznesit japin para për partitë politike me ju ndalu të paktën për dhjetë vjet që mos me pas të drejtë me qenë pjesë e procesit të tenderimit publik. Me e rregullu mënyrën e financimit të partive politike...

**KRYETARJA:** Ju kisha lut me qetësi merreni është propozim dhe diskutim ...

**ARTAN CANHASI:** 4.sa milionë euro i jep buxheti i Kosovës në vit për partitë politike unë e konsideroj që është e mjaftueshme për funksionim të partive politike në Kosovë. kështu që nuk ka nevojë partitë politike të kërkojnë donacione të jashtme nga bizneset ose nga individët që kanë biznese, sepse mundet me ju mjaftua buxheti që marrin prej Kuvendit.

Ka plot shtete në Bashkimin Evropian që këtë fushë e kanë të rregulluar në këtë mënyrë, për shembull Franca është shteti i cili e ka shumë në mënyrë rigorozë të rregulluar që vetëm prej buxhetit të shtetit mundesh me marr para për me e financua edhe fushatën edhe funksionimin e partisë politike dhe nuk ke të drejtë me kërku para jashtë kësaj.

Çështje tjetër e rëndësishme është me u rregullu edhe me u rregullu deklarimi i financave të kandidatëve brenda partive politike. Prej të dhënave monitorimit që ne i kemi bërë ka dal që ka individë që ka pas një pozicion të një ministri në një ministri shumë të fortë të caktuar edhe që biznesi që e kanë marrë tenderin në atë ministri kanë jap shumë para për partinë politike po njëkohësisht shumicën e atyre parave që ne për at parti politike i ka shpenzu pikërisht ai kandidati që ka qenë ministër në atë ministri.

Po këto i kemi qu të gjitha në prokurori, janë diskutuar edhe në Kuvend mirëpo rezultati prapëseprapë është zero.

**KRYETARJA:** Zoti Osmani, nuk të ndërprejti askush në diskutimin tënd ju kisha lut me e respektu fjalën e Artanit.

**ARTAN CANHASI:** Këto nuk janë supozime janë realitete që ne i kemi marrë prej institucioneve tona, ne nuk i kemi shpik të dhënat, ne nuk i kemi shpik as 260 milionëshin, as 100 milionëshin e më herët që ka qenë, këto janë të dhëna që kanë dal prej raporteve të auditorit dhe janë disa prej edhe rekomandimeve që janë bërë në raport të auditorit që asnjëherë nuk janë zbatuar.

Domethënë këto nuk janë shpikje, nuk janë ardh as nga Marsi as nga Hëna janë këto gjëra që ne ballafaqohemi çdo ditë. Kështu që nëse e kemi për synim me e

rregullu fushën... jo jo unë e lidha bizneset që po marrin tenderë po japin para për fushata të partive politike, të lutem, kjo ka lidhje direkt. Nëse unë sot të jap një partie politike 50 mijë euro pse 20 mijë euro për me ia financu fushatën dhe nesër i marr 20 milionë euro tenderë kjo është lidhje, dhe këtu janë drejtuesit e Agjencionit Kundër Korrupsionit munden të tregojnë për riskun e madh që i kanoset kësaj lidhje për shfaqje të korrupsionit politik direkt, sepse nëse unë të jap pak para nesër marr më shumë pikërisht prej teje normalisht që kjo është risk i madh i shfaqjes së korrupsionit politik dhe këto të dhëna janë të dhëna zyrtare që ne i kemi marrë prej raporteve zyrtare.

Edhe unë i konsideroj që këto janë pika që duhet shumë me u rregullua nëse i hyhet ndryshimit të Ligjit për financim të partive politike. Çështja e auditorëve unë prapë e konsideroj çështje teknike, Kuvendi ka mundur me alokua buxhet shtesë, sepse nëse flitet sot, nëse sot vjen në Kuvend të Kosovës Ligji për rritje të pagave të deputetëve dhe rritje të mëditjeve të deputetëve nuk besoj që asnjë deputetë ka me dal kundër kësaj edhe nuk ka pas shansë të dështojë katër vite kjo çështje edhe mos me e shtua buxhetin për me e auditua financat e partive politike.

Unë këtë e konsideroj mungesë të vullnetit politik edhe mungesë të seriozitetit të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit! Zoti Osmani nëse ke mundësi, në qoftë se nuk të pëlqen debati atëherë dera që ku është.

**ARTAN CANHASI:** Më fal, të lutna cila është dezinformata këtu?! Unë e thashë nëse sot propozohet një ligj i tillë qysh u propozua pak më herët dhe u pa që ka një konsensus për me u rrit normal edhe momenti kur e patë reagimin e publikut e kthyet mbrapa. Unë nuk po them që ka ndodh kjo...

**KRYETARJA:** Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri. Unë ju kisha kërkuar me qëndruar në temë e po ashtu jo tensione.

**ABDYL YMERI:** Faleminderit, kryetare!

Përsëndetje për të gjithë,

Ajo që është në interes të publikut mendoj unë që është të dihet saktë se si financohen partitë politike dhe si i shpenzojnë paratë. Mendoj që përderisa ne diskutojmë ne ende kemi mungesë të kontrollit dhe mbikëqyrjes së financave të partive politike, e cila qon deri në mungesë të transparencës që është element kyç sepse rritja e transparencës do të thotë rritje e besimit të qytetarëve.

Unë jam paksa i impresionuar prej diskutimeve që po i dëgjoj sot këtu, mirëpo edhe shoh një vullnet që ka ardhur do të thotë një vullnet politik që realisht subjektet politike të auditorëve. Ne këtu mund të bëjmë njëfarë politike mirëpo, duhet të kemi parasysh që 4 vjet partitë politike nuk janë auditua. Ajo se është për mua edhe për kolegët që ne kemi diskutuar në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave, kur është miratuar Ligji për zyrën e auditorit kombëtar kemi propozuar që pjesa e financave e cila jepet për subjektet politike do të thotë ka qenë propozimi ynë që të auditohet nga zyra kombëtare e auditimit. Mirëpo ka pas reagime të ndryshme besa ka pas reagime edhe prej shoqërisë civile, edhe gazetarëve, ... .. edhe e kemi lënë qysh është deri tash.

Për mua kjo forma që i është lënë Kuvendit e konsideroj që nuk është e mirë dhe në rast se e shikoni nenin 7, pika 2, thotë “fondi për mbështetjen e subjekteve politike funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Kjo e drejtë për mendimin tim është ashtu qysh tha kryetari i Komisionit për Buxhet kjo duhet të kalojë atje. Çka ka me u marr Kuvendi me këto. kjo forma e përzgjedhjes, e mënyrës së përzgjedhjes së auditorëve sikur është deri më tash po shihet që nuk është adekuate dhe vazhdon të mos zgjidh probleme.

Propozimi im ka qenë edhe unë mendoj që tash mund ta rregullojmë në rast se duheni me e bë, këtë pjesën e financave publike që jep do të thotë prej fondit të buxhetit të Kosovës për partitë politike gjithsesi të auditohen prej Zyrës Kombëtare të auditimit. Kurse, këtë pjesën tjetër prej donacioneve, prej anëtarësisë të gjitha ato është mënyra duke zgjedhur auditorët privat sipas shortit. Dhe unë konsideroj që kishte me qenë forma më e mirë me u zgjedh kjo problematik sepse kjo në rast se vazhdon kështu ne mund të diskutojmë po nuk shoh ndonjë zgjidhje që mund ta bëjmë shpejt.

Në rast se kërkohet që ta bëjmë shumë shpejt unë konsideroj që duhet me ia lënë KQZ-së, a forma më e mirë kishte me qenë se për mua institucioni më kredibil edhe i besueshëm është Zyra Kombëtare e auditimit. ... me ju thënë të drejtën as këtyre auditorëve privat fort nuk kam shumë besueshmëri për faktin se ti mundesh me ua dhënë dikujt edhe ai ta bën sipas dëshirës sa i përket këtij publikimit të raporteve që janë dikush se i ka publikuar më herët e dikush që i publikoi më vonë, këto janë të pabesueshme. Ato janë mbushur sipas, unë kam mundur t'i mbush sipas dëshirës sime. Do të thotë, këto duhet të auditohen, kur të auditohen edhe publikohen. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, zoti Ymeri! Fjalën e ka zonja Albana Medja nga Grupi... kërkoi ndjesë, Dren Ajeti nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Vetëm tua tregoj radhën, pastaj e ka Deputeti Ali Sadriu, pastaj përfaqësuesja e KQZ-së, zonja Miradije Mavriqi e cila edhe e kundërshton, me sa e di unë, këtë formë që t'i lihet KQZ-së dhe pastaj vazhdojmë me deputetin Enver Hoti, Ilir Cacaj dhe përfaqësuesi nga OSBE-ja.

DREN AJETI: Faleminderit, zonja Haxhiu!

Unë jam Dren Ajeti nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Ne si ... .. dhe si organizatë joqeveritare përherë kemi qenë të interesuar në lidhje me çështjen që është duke u diskutuar sot dhe mirëpres këtë takim. Të jem i sinqertë, qysh në vitin 2013 ndoshta ky takim ka qenë i nevojshëm të organizohet, por që thonë më mirë vonë se kurrë.

Problemi qëndron në atë, se brenda kësaj periudhe kohore, që nuk janë audituara partitë politike, po flasim për rreth 3 vjet, do të thotë 2013 deri në vitin 2016, kanë qenë dy ose tri palë zgjedhje dhe gjatë kësaj periudhe janë derdhur një shumë e madhe parash dhe unë besoj se qytetari i këtij vendi ka të drejtë të dijë se këto para ku kanë shkuar.

Ne mund të diskutojmë rreth asaj se ku dhe qysh, tek, qëndron problemi dhe të jem i sinqertë, jo se po dua tash ta marr Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mbrojtje, por kanë qenë dy-tre iniciativa të cilat janë marrë prej këtij komisioni lidhur me auditimin e partive politike.

Unë personalisht besoj që problemi është pikërisht tek ligji, sepse Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike më shumë vepron si ndërmjetësues në mes shpalljes së tenderit për auditorë, mirëpo prapë do të thotë besoj që ne do të thotë i diskutuam shumë çështje po munguan do të thotë udhëzime ose qysh me than plane direkte se çfarë do të veprojmë. Ne besojmë që urgjentisht duhet të krijohet një grup punues ndoshta mes deputetëve të këtyre tri komisioneve gjegjëse që të diskutohet se ku qëndrojnë problemet.

E di që vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht sekretariati, e pati organizuar një takim me auditorët, të cilët u ankuan se për këto tre vjet ose dy vjet atëherë ishte, buxheti prej 60 mijë eurosh është i vogël. Mund të themi që ndoshta po kërkojmë më shumë, ndoshta janë duke luajtur lojë biznesit ose diçka të ngjashme, mirëpo ligji e definon se janë auditorët ata që kanë me e bë auditimin e këtyre dhe besoj që Kuvendi i Kosovës gjegjësisht buxheti duhet tu përshtatet, natyrisht duke mos e tepruar, por duhet të shikohet se cili është çmimi real për një auditim dhe cili

është çmimi që e kërkojnë auditorët dhe në bazë të kësaj do të thotë të bëhet edhe përshtatja e buxhetit përkatës.

Zoti Osmani na njoftoi që sivjet, do të thotë është bërë rritja e buxhetit në 120 000 euro dhe unë besoj se duhet të provohet edhe një herë, se a po arrihet diçka apo nuk po arrihet në këtë fushë. Nëse prapë e shohim që edhe buxheti prej 120 000 eurosh nuk del, ose problemet qëndrojnë krejt diku tjetër dhe ne besojmë që ky grup punues duhet të bëjë definimin e problemeve, ku po qëndron problemi. A është problemi që sistemi anglez, të cilin ne e kemi adaptuar, do të thotë që Kuvendi me e bë auditimin, a është kjo në rregull apo është faji tjetërkund apo ndoshta duhet ta marrë AKP-ja përsipër apo ndoshta ta marrë KQZ-ja përsipër apo ndoshta duhet ta marrë edhe auditori i përgjithshëm, siç ka qenë propozimi i këtij komisioni.

Në rastin që e përmendi zoti deputet, problemi ka qenë më shumë një dilemë kushtetuese, se a është auditori i përgjithshëm ose auditori kombëtar, a mund ta marrë përsipër një detyrë të tillë, deputetët kanë qenë të mendimit se nuk paraqet një dilemë kushtetuese. Në fund u tërhoq nga ky propozim, mirëpo unë besoj që takimi i sotëm duhet të jetë shtysë drejt asaj, unë besoj që është shumë mirë që jashtë krejt strukturës politike dhe jashtë interesave politike, sot pranuar me u ulë. Mund të diskutojmë pse, qysh, tek, ka ardhur deri këtu, por vullneti po ekziston që të vazhdohet me këtë punë dhe unë besoj se duhet të themelohet gjithsesi ky grup punues, që t'i evitojë problemet se ku qëndrojnë hallet, pse nuk është bërë që tre vjet ky auditim. Të mos harrojmë, që sivjet prapë kemi zgjedhjet lokale, sivjet ose vitin e ardhshëm do të jenë zgjedhjet parlamentare, varësisht prej vullnetit politik. Dhe, nëse ne sivjet nuk e bëjmë auditimin e partive politike, në vitin 2017 po shtohen edhe dy palë zgjedhje dhe unë nuk jam ekspert i auditimit, nuk e di qysh shkojnë këto punë, po veç me diskutua që janë 4-5 palë zgjedhje që kanë me u auditua, plus auditimi i financave publike jashtë këtyre zgjedhjeve. Besoj, që po të kisha qenë unë auditor do të kisha pasur frikë të marr një barrë të tillë përsipër.

Kështu që, besoj edhe një herë po e ripërsëris, është mirë që prej këtij takimi të dalë një grup punues, me deputetë, me aktorë të shoqërisë civile e pse jo edhe me ekspertë ndërkombëtarë dhe të shikojmë ku janë problemet dhe përfundimisht të ofrohet një zgjidhje.

Unë si qytetar kam të drejtë të di se ku po i harxhojnë partitë politike paratë e mija, ndoshta nuk është ndonjë shumë e madhe, por kam të drejtë për çdo cent që i është dhënë partive politike, ta di se ku është harxhuar ajo shumë. Faleminderit!

KRYETARJA: Naser Osmani e paska marrë sot rolin e... me diskutua për secilin fjalim. Deputeti Ali Sadriu nga LDK-ja e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Më vjen mirë që po e diskutojmë këtë temë, edhe pse kjo temë është diskutuar në disa nivele të tjera edhe më të larta. Për habinë time, tash po kthehemi prapë në nivel tjetër. Praktikrat flasin, se kur veprojmë kështu nuk jemi shumë seriozë në trajtimin e asaj teme.

Ka qenë i kyçur këtu kryeparlamentari, ka qenë i kyçur Bashkësia Evropiane përmes përfaqësuesit të vet e kush jo tjetër dhe tash jemi kthyer përsëri në një nivel tjetër të zgjedhim modalitetet se si t'i qasemi kësaj çështjeje.

Mendoj se ne duhet dhe kemi nevojë për konsultime të gjëra, por në fund duhet të vendosim vetë. Dhe, pasojë pse jemi këtu është pikërisht se kemi dëgjuar tepër. Ne duhet të konsultohemi tepër, por nuk duhet të dëgjojmë tepër. E kurrkush nuk i njeh problemet e Kosovës më mirë se që i njohim ne, absolutisht kurrkush nuk i njeh më mirë.

Ky ligj kur është miratuar, është miratuar me qëllim që të na sjellë në këtë situatë. Me vetëdije e pa vetëdije, unë nuk e di. Merren i ligjin, lexojeni, i lyp me qenë 10 auditorë ligjorë të licencuar. Ma gjeni një kompani në Kosovë, mund ta gjesh një me përmasa Delloite... ose dy, por që ato s'kanë nevojë, se tregu i Kosovës kjo si fushë është lënë i pa trajtim adekuat dhe mua, sa më dhemb partitë politike dhe më dhemb shumë edhe te ndërmarrjet publike.

Unë nuk e dëgjova asnjë medie, nuk e dëgjova asnjë OJQ, që diskutuan se si u dha tenderi për auditimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit 10 milionë euro. A di dikush të ma shpjegojë këtë? Dy kompani i ke dhe ata i gjejnë dy të trasha dhe s'kanë nevojë të merren me këtë. Pse të hyjë ai? 30 mijë euro ka qenë buxheti, tash është bërë 100 mijë, se 30 mijë ka qenë kur e kemi marrë ne prej KQZ-së ka qenë 30 mijë euro.

Pastaj, thash këtë ligj nëse duam ta zbatojmë ti s'mund ta kryesh këtë auditim, se nuk i ke 10 auditorë të licencuar. Të shikojmë institucionet, në cilat kanë mundësi potencial në bazë të këtij ligji? Përrjashtimisht hiq Zyrën Kombëtare të Auditimit që ka auditorë të licencuar, unë nuk e di që ka tjetër dhe normalisht, që mungesa e ofertës ka sjellë deri këtu. Nuk kanë qenë... kanë qenë përpjekjet e pareshtura të



komisionit dhe të Kuvendit me ardhur kjo çështje dhe me u krye moti. E kam ngritur unë edhe nëpër seanca, e kemi diskutuar në të gjitha nivelet.

Pra, ndryshimi i ligjit është imperativ, por të shikojmë ku po duam dhe paralel kësaj dua ta thërras vëmendjen e atyre që janë jashtë dhe po ngrenë çështje, të ngritët auditimi i ndërmarrjeve publike, atje janë hajnitë më të mëdha. Atje bëhet auditimi me kontraktim. “Ma bëj ti auditimin, ky është çmimi, përktheje edhe këtë çmim për atë tjetrin...” kam të drejtë kështu të them dhe, ju të gjithë keni të drejtë kështu të thoni, sepse problemet po ndodhin dhe ato realisht nuk po hidhen në sipërfaqe.

Një iniciativë ka qenë që Kuvendi t’i pranojë 10 auditorë të pavarur. Këtë iniciativë e ka nisur Zyra Kombëtare e Auditimit në krye me ... , flas para dy tri vjetësh. Dhe, ka dhënë arsyetimin e vet shumë të plotë, për mua, sepse ne i kemi diku 36 apo 38, nuk jam i sigurt, agjenci të pavarura që janë të lidhura drejtpërsëdrejti me Kuvendin, nuk i raportojnë Qeverisë, raportojnë në mënyrë formale në Kuvend, formale po them se vetëm raportin vjetor kur e japin. Dhe, si të tilla, veprimet e tyre janë të pakufizuara. Nëse është bërë ndonjë auditim, dalin aty gjëra të tmerrshme dhe mbesin në letër.

Unë i kam potencuar ato, opinionin e di shumëçka prej tyre që janë gjetur edhe në institucione po edhe në këto agjenci. Për shembull, veç një rast po ua marr, HIDRO-Drini. HIDRO-Drini me emër të performancës se kanë punuar mirë, i kanë marrë 23 paga brenda një viti. Kur ia hulumton performancën, del se veç 17% e ka inkasimi e tërë prodhimin që e bën. Sa në humbje, sa në faturim, por kur vjen te inkasimi mbetet 17%, kurse merret performancë 23 paga, domethënë 100% gati po i bie se kanë qenë shumë efektivë në punë.

Mirë është që po i trajtojmë ne partitë politike dhe dashtë Zoti, ne do ta zgjidhim këtë problem, se mendojmë të jetojmë këtu, por unë u sugjeroj, kolegë, që ne këshilla të marrim sa më shumë, por në fund vendosim vetë. Potencial, thash, ka vetëm Zyra Kombëtare e Auditimit, të tjerët do ta luajnë rolin që e ka luajtur Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, nëse e qesim në antikorrupsion, ky s’ka potencial dhe s’është mirë me e pas brenda vetes këtë njësi. Ai do ta shpallë tenderin, do ta gjejë një, por s’e di sa është funksioni i saj, s’di pse t’ia ngarkojmë.

Kjo ka qenë në KQZ dhe deri sa ka qenë atje ka rrjedhur mirë, por sa është edhe ajo e mirë, se edhe ata janë politike. Tash mund ta quajnë veten si të duan, partitë politike i emërojnë, prandaj për logjikën time ka qenë më e logjikshme ajo që e ka

dhënë LAGE në atë kohë, që Kuvendi domosdoshmërisht t'i pranojë 10 auditorë të licencuar dhe paga e tyre sado të jetë për njërin 12 mijë a 13 mijë euro më së shumti po shkojnë. 10 – 120, që një auditim i një viti, ata e paguan plus asaj ata do të kryejnë auditimin për 36, gjegjësisht 38 agjenci të pavarura, që realisht ne nuk e dimë se si po veprohet dhe cili është rezultati.

Nuk është mirë këto të përdoren për material për fushata të vlerësimeve partiake, e kam publikuar, s'e kam publikuar... Mirë që e ke publikuar, po s'ke bërë ku me ditë çka. Jo, që s'ke dashur ti, por s'ka vlerë ajo, se ajo nuk ka besueshmëri. Unë po dua të gjejmë diçka zgjidhje, nuk po i qortoj pse e kanë bërë, por po dua të them kështu siç është nuk ka asnjë efekt. Për të pasur efekt ajo është dashur të auditohet dhe të shikohet pastaj edhe auditimit t'i bëhet edhe për performancën e jo veç i rregullsisë. Te auditimi i rregullsisë ato janë parimet e punës që ... për mentalitetin tonë që merret, realisht nganjëherë na bjen në logjikë paadekuate, sidomos ata që vjen pa ... mund të dalë, që unë kam punuar shumë keq, por i kam prezantuar të gjitha të dhënat dhe unë dal se kam bërë opinion shumë të mirë. ti ke punuar shumë mirë, por s'i ke prezantuar të dhënat mirë, ti del se ke opinion të kundërt, opinion pa kualifikim me theks të çështjes, e tjera, e tjera...

Do të thotë, janë disa çështje, që duhet të trajtohen në këtë ligj, me u qartësua në këtë ligj. Çfarë duhet të bëhet ai auditim, cili është ai. Pastaj, të ndalem edhe te ajo që e ngriti kolegu, në Ligjin për menaxhimin e financave publike e ke shumë qartë, edhe një euro qoftë euro publike, ajo duhet të auditohet, edhe një euro, jo se ne e kemi..., ta marr RTK-në, mbi 10 milionë i merr. Kuvendi nuk ka aq buxhet. Edhe auditimin, këndeje ankohet që s'kam para, andej del edhe blen auditorët për t'ia bërë auditimin siç i duhet. Kjo është anomali, që do të eliminohej në shumë çka nga ajo e unë po e ngre me qëllim që të ju bind edhe juve, se nevojë imediate është që Kuvendi duhet ta ketë njësinë e vet. Kuvendi është trup më i përgjithësuar, profesionalë zgjidhen, vishet me autoritet të pavarësisë ajo njësi dhe i kryen jo veç partitë politike, por i kryen edhe të tjerat.

Dhe, thirrja tjetër është, që Ligji për auditim të ndërmarrjeve publike duhet të ndërrohet menjëherë. Nëse duam ne t'i themi stop në zanafillë procesit të keqpërdorimeve, hajnive, është këtu. Se, ato bëhen ende pa e shpallur tenderin, ai i ka të planifikuara në kokën e vet, se në cilat dispozita duhet thirrur dhe që të mbetet i pandëshkuar.

**KRYETARJA:** Faleminderit, zoti Sadriu! Fjalën e ka përfaqësuesja e KQZ-së, zonja Miradije Mavriqi.

MIRADIJE MAVRIQI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Pa dashur të ndalem në nenin 19 kisha dashur që ta përflasim, ose të shprehim vërejtjet tona, ose mangësitë edhe të nenit 15 po të këtij ligji.

Ju lutem, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron partitë politike, mirëpo i certifikon edhe nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur. Neni 15 thotë, citoj: “Subjektet e regjistruara politike dorëzojnë në KQZ raportin.” Çka nënkupton kjo? Ku mbeten subjektet tjera të certifikuara, do të thotë, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur?

Kështu që, ky nen është i paqartë edhe jo që subjektet politike kanë ngecur në dorëzimin e raporteve me insistimin tonë, sepse ndoshta ka qenë ashtu ad hoc a ku e di unë, mirëpo kjo është e paqartë. Desha vetëm këtë problem ta ngre. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Mavriqi! Fjalën e ka deputeti Enver Hoti nga Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Përshëndetje për ju, për deputetët e të gjithë të pranishmit!

Me të vërtetë po shihet se ka pasur nevojë urgjente që të takohemi në një tryezë të tillë, për të trajtuar këtë çështje shumë të rëndësishme. U ngritën çështje dhe u dhanë argumente nga më të ndryshmet. Mendoj që asnjë argument dhe asnjë qëndrim, sado që ne tentojmë të arsyetojmë veprimin tonë si deputetë, si përfaqësues të partive politike, nuk do të arsyetojë mosauditimin që ka treguar. Nuk ka asnjë argument që ne sjellim këtu, qoftë si Kuvend, qoftë si zyrtarë të partive politike, që do ta arsyetojmë këtë gjendje që është krijuar tani. Dhe, këtu duhet të konstatojmë që nuk mendoj që ligji është krejtësisht fajtor. U tha nga disa folës këtu, që ndoshta alkimi i pakët i mjeteve ka mundësuar këtë gjendje, mirëpo sigurisht edhe kjo e ka një qëllim në vetvete, se duhet si bindje ta themi që i ka konvencuar dikujt. Dhe, kjo sigurisht u konvenon atyre që janë më të fortë, që të mos auditohen.

Nuk do të bëja në këtë tryezë ndonjë debat me subjektet politike që jemi këtu, por sigurisht se kjo është gjendja. Mendoj që ne duhet të dalim me disa qëndrime konkrete, ose unë i kisha dhënë dy qëndrime: një të shikojmë mundësinë, a ka mundësi që të bëhet një auditim i partive politike pa shkuar në zgjedhje, këtë afat ku jemi, që ne si Kuvend, si institucion, të marrim obligimet tona dhe të krijojmë

një mundësi që të bëhet një auditim pa shkuar në zgjedhje, qoftë në zgjedhjet lokale ose në zgjedhjet që mund të jenë të parakohshme, nën një.

Nën dy, mendoj që duhet t'i qasemi seriozisht Komisionit për Buxhet dhe Financa ndryshimit dhe plotësimit në tërësi të Ligjit për financimin e partive politike dhe këtë iniciativë duhet ta marrim ne e mandej t'i krijojmë të gjitha mundësitë dhe aktorët që mund të kontribuojnë në këtë drejtim dhe të nxjerrim një ligj që do të jetë i përshtatshëm dhe funksional dhe do të jetë i zbatueshëm. Mos të ketë hapësira dhe defekte në të cilat ne pastaj mund të fshihemi pas tyre apo mos t'i kryejmë detyrat tona si qytetarë që jemi edhe në kuadër të ligjit.

Për tema tjera, zoti Sadriu, faleminderit që ngrite disa tema edhe ai zotëria atje i organizatave joqeveritare. Edhe një herë ju falënderoj juve OJQ-ve që jeni këtu, sepse po kontribuoni shumë, mirëpo krejt ajo farë lidhje, që the ti që bëhet në mes institucionit e ndërmarrjes publike te agjencitë dhe te zyrtarët e grupet formale e joformale do t'i quaja me një përmbledhje. Ishalla nuk na shkel ajo rrotë aq e madhe e keqpërdorimit të parasë publike, se ka me të shkelë edhe ty, edhe mu, edhe të gjitha institucionet.

Është e qartë, se raportet e auditorit të përgjithshëm jo që nuk plotësohen ato rekomandime, por nuk trajtohen në asnjë mënyrë. Kemi krijuar mekanizma të tërë të taskforcave kundër korrupsionit e organizata të ndryshme, të ndryshme kemi krijuar, por punën e tyre s'po dinë ta bëjnë. Ne kemi pasur takime edhe me auditorin e përgjithshëm. Auditori i përgjithshëm e ka thënë qartë, se nuk ka asnjë mundësi përpos raportimit që e bëj, me e ndjek më tutje ose me e shty punën e vet, për me u hulumtua ose me u trajtua, me reagua dikush, qoftë nga ai që i drejtohet, qoftë nga institucionet, të cilat janë të obliguara me e mbrojt edhe me e kontrollua menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike.

Mirëpo, këto tema sigurisht se kërkojnë një debat tjetër, kërkojnë një organizim tjetër dhe ne do të jemi këtu për të dhënë kontributin tonë. Unë edhe një herë po e përsëris, se ne mendoj se duhet të përqendrohemi në atë a kemi mundësi të bëhet një auditim pa shkuar në zgjedhje lokale, i partive politike, dhe nën dy, t'i qasemi ndryshimit dhe plotësimit të ligjit aktual për financimin e partive politike. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit, po ashtu, zoti Hoti! Fjalën e ka Ilir Cacaj, pastaj përfaqësuesi i OSBE-së, Albert Krasniqi, domethënë pas OSBE-së Albert Krasniqi, pastaj deputeti Hajdar Beqa, Synavere Rysha dhe Malten Majer dhe Fehmi Pireva në fund.

Ju kisha lutur, deri në ora 1 kemi mundësi të qëndrojmë këtu, domethënë të kufizoheni në pak minuta.

**ILIR CACAJ: Përshëndetje!**

Unë jam Ilir Cacaj, jam përfaqësues ligjor financiar i Lëvizjes “Vetëvendosje” gjashtë vjetët e fundit, në fakt prej se “Vetëvendosja” ekziston si subjekt parlamentar.

Nëse ka ndonjë lëmi që e njoh mirë, është kjo dhe me këtë rast po dua të shkëpus disa pika të shkurta, por që unë i konsideroj si thelbësore, sa i përket temës në fjalë, drejt gjetjes së një zgjedhjeje apo rregullimi, se si duhet të rregullohet kjo çështje.

E para, nuk e kam dëgjuar asnjëherë të përmendet në Kosovë, as në këtë forum, unë nja dhjetë herë së paku kam qenë në KQZ, ku e kam ngritur zërin, pra i kam dhënë propozimet e mija, nja dy herë në Qeveri. Kjo është hera e parë që marr pjesë në një komision parlamentar për këtë temë dhe nuk është dëgjuar themi, nuk po them pse, por nuk janë dëgjuar asnjëherë propozimet e mija personale por as të përfaqësuesve tonë nëpër institucione të ndryshme, përfshi edhe Kuvendin, për propozimet që ne i kemi sa i përket edhe legjislaturës, por edhe qysh duhet të funksionojë, të themi, financat e subjekteve politike.

Unë po shkëpus shkurtimisht çështja e parë dhe më e rëndësishme, sa u përket subjekteve politike, është definimi i statusit të tyre. Subjektet politike në Kosovë nuk janë as organizata buxhetore, as OJQ, as biznese, domethënë kanë një status totalisht të paqartë, se çfarë lloj institucioni është subjekti politik. Kështu që, në qoftë se duhet bërë një punë të vlefshme Komisioni për Legjislacion apo komisionet tjera, unë këtë nuk e di. Është e para me e definua statusin juridik të subjektit politik, sepse pa e ditur statusin politik edhe vetë subjektet nga brenda, që unë po ua tregoj prej përvojës, që kemi probleme të themi edhe të funksionimit sa u përket financave, por statusi do të definonte edhe kujt i jep llogari, të themi, subjekti politik, sa i përket shpenzimeve në bazën ligjore.

Unë do të propozoja, tash nuk është e imja të them ta definoj, mirëpo mund të ishte organizatë buxhetore dhe si e tillë, automatikisht auditimi i financave të subjekteve politike bëhet prej auditorit të përgjithshëm dhe kjo nuk ka nevojë të ketë më diskutime të mëtutjeshme, se apo ping-pongë nga të tipit në dekadën e fundit një herë e ka pasur KQZ-ja, i ka kaluar Kuvendit, i ka kaluar prapë KQZ-s, tash prapë Kuvendit, tash prapë Kuvendi do t’ia kalojë KQZ-së. Domethënë, po më duket një humbje kohe dhe jo përcaktim i duhur.

Kështu që, në se e definojmë statusin e subjekteve politike, me këtë rast definojmë edhe se kujt i raporton subjekti politik, kush e auditon, e tjerë...

E dyta, sa i përket bazës ligjore, ligji është jo i mirë, ka plotë kundërthënie në ligj. unë kisha propozuar, unë s'po them se në Kosovë s'ka njerëz që mund ta përpilojnë këtë ligj. Besoj që ka shumë të tillë. Thjesht, atyre nuk po u jepet hapësirë që të japin kontributin e tyre, por edhe nëse nuk duam të humbim në kohë, unë kisha propozuar me e marrë një copy-paste një ligj të një shteti tjetër, kjo nuk është asnjë gjë e keqe, mund ta shfrytëzojmë të fillojmë punën. Ndërsa, sa i përket parimit të financave të subjekteve politike, mendoj që është një nga çështjet më të rëndësishme në Kosovë, për arsye se ne po harrojmë një gjë që subjektet politike udhëheqjen, kërkoj falje pak nëse ... veç ta përmbyll. Nëse ne pajtohemi të gjithë që subjektet politike kërkojnë votën dhe udhëheqin shtetin pra, në Kosovë dhe me këtë rast menaxhojnë me milionë e miliarda euro të Kosovës, atëherë do ishte shumë e rëndësishme t'i shohim si i menaxhojnë paratë publike në subjektet e tyre politike.

Pra, nuk mund ta minimizojmë siç është minimizuar deri më tash dhe të themi, financimi i subjekteve politike. Unë mendoj se është një çështje që pothuajse shumë pak kujt i intereson, përfshi edhe deputetët. ka disa zëra që unë mendoj që nuk janë adekuatë edhe nga shoqëria civile, tash do ta them përse, pra çfarë po kërkojnë ata. Ndërsa, sa i përket transparencës, se po dëgjoj disa deputetë që po thonë “keni qenë transparentë, tani çka?” domethënë, i bie që paskemi bërë gabime ne që paskemi qenë transparentë. Duhet me u rikthye me u bë si të gjithë të tjerët, domethënë me i heq raportet, se s'e paskemi bërë namin, që paskemi qenë transparentë.

Unë si e kuptoj transparencën, të paktën, e nënkuptoj që ti nuk je transparent vetëm kur je mirë, ti je transparent, tregon kush je, e nëse je mirë apo nuk je mirë, këtë e vlerëson qytetari dhe tjetërkush.

Unë kam treguar me raporte financiare.

*(Debat në sallë... nuk dëgjohet.)*

**KERYETARJA:** Zoti Sadriu, edhe ju ky është dëgjim publik, është debat publik,... ky është debat publik, mua më vjen keq që irritoheni prej diskutimeve të njerëzve, por askush, askujt s'ia ndërpreu këtu fjalën. Kështu që, ju kisha lutur, të keni pakëz durim.

ILIR CACAJ: Të tregova në fillim, se kush jam, zotëri. Unë jam përfaqësuesi financiar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

KRYETARJA: Ju kisha lutur për pak durim, dikujt që s’i pëlqen debati, e ka derën, i thash edhe deputetit Osmani, kështu që ju lutem për qetësi. Zoti Cacaj... në se ke mundësi...

ILIR CACAJ: Po e përmbyll. E fundit që kam është kjo, jo pse kam ndonjë kritikë për shoqërinë civile dhe OJQ-të, përkundrazi. Por, unë do të kem një sugjerim për ta. Raportet financiare që duken në ueb-saujt do t’i auditorë një, të themi, organ kompetent dhe i pavarur. Unë këta i kisha inspiruar dhe ua kam thënë vazhdimisht nëpër takime, kur kemi ndenjtur. Këta duhet të hulumtojnë atë që nuk shihet. Pra, duhet të hulumtojnë të gjithë qarkullimin financiar.

*(Debat në sallë... nuk dëgjohet.)*

KRYETARJA: Zoti Cacaj, nëse ke mundësi...

ILIR CACAJ: Po. Unë them atë që e njoh dhe atë që e di dhe që mendoj se është e vërtetë edhe do ta them gjithmonë. Nuk jam një zyrtar i thjeshtë, por jam përfaqësues financiar, zyrtari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, zotëri. E njoh këtë temë shumë mirë, ndoshta më mirë se ju. Por, po dua të them që... po me ata po flas, s’po flas me ju. Unë po flas me komisionin, nuk jeni veç ju këtu. E përmbylla me këtë.

Do ta inspiroja, sidomos, Shoqërinë Civile që të hulumtojë atë që nuk shihet, pra çfarë i bie kjo, një qarkullim i hatashëm i parasë nëpër fushata, sidomos, e padeklaruar, ku financohen fushata milionëshe dhe me ligj nuk lejohen përmbi gjysmë euro për votues, kështu që unë me këtë po e përmbyll.

KRYETARJA: Faleminderit zotëri Cacaj! Unë singerisht nuk po e kuptoj, do të thotë, tendencën as të deputetit Osmani që të ndërhyhet pas secilës fjalë e as të deputetit Ali Sadriut. Është kompetencë e Komisionit për Legjislacion të ndërhyjë kudo që nuk zbatohen ligjet. Lexoni Rregulloren e punës të Kuvendit. Nuk e kam thirrur kokë n’veti, e kam thirrur me kërkesë të Komisionit për Legjislacion.

Prandaj, këtë tryezë e ka mbështetur edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e po ashtu edhe Komisioni për Buxhet e Financa.

*(Ndërhyrje)*

Unë nuk ndërhyra në asnjë moment të fjalës tënde, që s'pajtohesha fare, kështu që të kisha lutur të kesh durim. Në qoftë se nuk të pëlqen kjo tryezë, ja ku e ke derën, mundesh me dalë jashtë. E ka fjalën përfaqësuesi i OSBE-së.

**FITIM MULOLLI:** Faleminderit shumë! Jam Fitim Mulolli, zyrtar për çështje politike në OSBE – Misioni në Kosovë.

Shumë shkurtër kisha dashur të ofroj asistencën tonë, kryesisht përmes ODIR-it që ka një përvojë mjaft të madhe në rregullativin e partive politike së bashku me Komisionin e Venedikut.

Ndihma sa mund të ofrohet, nëse ju mund të shihni të arsyeshme, kuptohet, është në dy faza. Në fazën e parë, nëse si konkludim këtu nxirren 5-6 çështje më të rëndësishme të cilat duhet adresuar, ekspertë nga ODIR-i do të ishin të gatshëm që në bazë të atyre 5-6 çështje të përgatisin një përgjigje në formë të **Polise-piper** dhe për të cilin kishin ardhur vetë për ta prezantuar, pra në ndonjë takim të radhës i cili do të caktohej.

Faza e dytë e përkrahjes kishte me qenë përmes opinionit ligjor, në amendamentet që do t'i bëhen ligjeve. Çdoherë, kuptohet, nëse ju e shihni të arsyeshme këtë ofertë për ndihmë. Ju faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit! Fjala është për zotëriun Albert Krasniqi, e pastaj deputeti Hajdar Beqa.

**ALBERT KRASNIQI:** Faleminderit kryetare!

Përsëritje për të gjithë të pranishmit,

Unë shumë shkurtër do t'kisha dashur t'i ngris disa prej temave të cilat u diskutuan sot dhe të tentojmë të jap përgjigje në to.

Shpeshherë në Kosovë, kur po ndryshohen ligjet, po bëhen më të këqija se sa që kanë qenë ato parapraket, dhe diçka e tillë ka ndodhur edhe me Ligjin për financimin e subjekteve politike. Dhe, moskonsultimi i duhur dhe mosorganizimi i dëgjimeve publike, në raste të ndryshimit të ligjeve ose të miratimit të tyre, po prodhon edhe pasoja sikur këto që i kemi sot.

E kam fjalën më konkretisht, tek bartja e kompetencës nga ana e KQZ-së për t'i adituar subjektet politike të Kuvendi i Kosovës, gjë që s'ka qenë e nevojshme.



Partitë politike i dorëzojnë raportet e tyre financiare në KQZ dhe ky është institucioni adekuat i cili mund ta bëjë këtë punë.

KQZ nuk është subjekt dhe institucion i partive politike. Është institucion i pavarur dhe pavarësia e të cilit është e garantuar me Kushtetutë.

Tjetër janë ndikimet politike që janë aty, mirëpo ky është definimi ligjor – kushtetues i këtij institucioni.

Është diskutuar për idenë ose propozimet janë dhënë për të kaluar kjo kompetencë tek Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në atë kohë, dhe edhe interpretimi ynë dhe i Zyrës Ligjore të Kryeministrit dhe të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka qenë se kjo është në konflikt me Kushtetutën e Kosovës për shkak se kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm thonë se auditohen vetëm subjektet juridike shtetërore.

Partitë politike nuk janë subjekte juridike shtetërore dhe si rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohen një auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Dhe kjo nevoja e e definimit ligjor të statusit të partive politike më së miri është të bëhet me një ligj të veçantë për partitë politike, e cila i mungon Kosovës dhe do të mund të caktoheshin disa kriteret minimale të funksionimit të tyre demokratik.

Ka një interpretim tjetër që e lidhin publikimin e raporteve vjetore financiare me pasqyra të audituara financiare. Këto janë dy raporte komplet të ndryshme dhe nuk kërkohet domosdoshmërisht që të publikohen bashkërisht. Kuvendi i Kosovës, të gjitha institucionet tjera shtetërore publikojnë në fund të vitit raportet e tyre vjetore financiare dhe tek kur të kryhet auditimi, diku në qershor, publikohen raportet e auditimit. Nuk ka pse të bëhet kjo ndërlidhje e panevojshme me të vetmin qëllim për të penguar publikimin e raporteve të tyre vjetore.

Megjthatë, edhe nëse ka pasur pengesa ligjore, që unë nuk po i shoh të tilla, Kuvendi ka shumë raste kur brenda ditës i kalon ligjet në dy lexime, dhe ka mund të bëjë brenda ditës, ta ndryshojë dhe t'i adresojë të gjitha pengesat, e jo të pritët 4 vite dhe edhe këtë vit, jam shumë skeptik që do të mund të ndodhë, për shkak se arsyeja kryesore është te buxheti i dobët dhe i pamjaftueshëm i mjeteve. Nuk është bërë asnjë analizë sa mjete janë të mjaftueshme për të kryer një auditim të tillë.

Në vitin e fundit, nuk ka pasur interesim të asnjë prej kompanive për të aplikuar, për shkak se ato thonë se kjo shumë nuk mjafton as për shtypjen e raportit dhe përkthimin në 3 gjuhë, e lere më të kryhet auditimi i partive politike.,

Pra, edhe këtë vit, një auditim i tillë është bërë shumë shabllon, vetëm duke e dyfishuar, që do të jetë e pamjaftueshme për t'i kryer të gjitha auditimet.

Me kaq kisha dashur ta përmyll këtë fjalë dhe të kërkoj ndryshim të ligjit dhe bartje të kësaj kompetence te KQZ.

**KRYETARJA:** Faleminderit zoti Krasniqi! Radha është të marrë fjalën deputeti Hajdar Beqa.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit kryetare e Komisionit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare,

Të nderuar përfaqësues të Shoqërisë Civile,

Ne sot po diskutojmë për Ligjin mbi financimin e subjekteve politike. Është një sfidë e cila realisht nga korriku i vitit 2013 që ka hyrë në fuqi ky ligj, dhe nuk kemi pas auditim të subjekteve dhe deri në atë kohë, sikur që edhe jeni të informuar, e u tha edhe nga parafolësit, kjo fushë është mbuluar nga KQZ.

Institucionet në atë kohë kanë menduar se është mirë legjislacioni të kalojë përmes këtij ligji por ky ligj në zbatueshmëri ka ardhur me probleme. Ne si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në çdo vit, në janar, në harmonizim me këtë ligj respektivisht nenin 19, i kemi marrë të gjithë hapat e duhur dhe na takojnë si Komision, i kemi iniciuar përmes Kuvendit këto procedura, por në mungesë dhe realisht edhe në konfuzitet të ligjit, që i ka pasur në këtë rast që i lypë 10 auditorë të licencuar, sikur që u tha edhe nga zoti Sadriu, po edhe në mungesë të buxhetit nuk kemi pasur një konkurrencë të duhur dhe nuk kanë pasur përzgjedhje. Do të thotë, kanë dështuar këto procedura.

Unë konsideroj se nuk është mirë të përdorim këtë takim për poena politike, por për zgjidhje të problemit, sepse ne që jemi këtu, sidomos deputetët, që janë përfaqësues politikë, unë nuk kam parë ndonjë hap që është ndërmarrë nga asnjë grup politik për inicim apo plotësim-ndryshim të ligjit.

Ne e dimë se edhe një deputet apo një grup i caktuar i deputetëve ka mund të marrë të paktën iniciativën, sepse është viti i katërt që s'kemi auditim të subjekteve politike lidhur me financimin e tyre.

Unë konsideroj se është në interes të vetë subjekteve politike transparenca në këtë rast dhe auditimi i financimit të partive politike dhe mendoj se nga ky takim duhet të dalim me konkluzë konkrete si të veprojmë më tutje, sepse ligjet janë të qarta, e nëse kanë ndonjë konfuzitet mund të ndryshohen.

Unë si deputet edhe kam qenë ithtar i asaj se kur u bë Ligji për Auditim në Republikën e Kosovës në vitin e kaluar, të shikojmë bazën ligjore dhe përmes Auditorit Gjeneral të bëhet edhe auditimi i subjekteve politike.

Realisht, sikur që u tha edhe nga parafolësit, ka pasur interpretime se është në kundërshtim me Kushtetutën, e në të njëjtën kohë edhe ai ligj thotë se Auditori i Përgjithshëm ka për detyrë t'i menaxhojë të gjitha paratë publike, dhe këtu flasim për fondin e partive politike, dhe të flasim çfarë është fondi që vjen prej buxhetit të Kosovës, dhe ai është para publike, sepse nuk financohen nga ndonjë paraje tjetër.

Megjithatë konsideroj se duhet të iniciojmë sa më shpejt, të bëhet një grup punues për ta bërë plotësim-ndryshimin e këtij ligji, të japin kontributin edhe komisionet përkatëse, dhe në këtë rast përveç Komisionit për Buxhet e Financa, Legjislacion dhe Komisioni për Mbikëqyrje, por edhe Shoqëria Civile e aktorë tjerë.

Mendoj se ne si Komision e kemi bërë që paralelisht në këtë vit të shkojmë me procedura të prokurimit në Kuvend dhe të përbëhet përzgjedhja e tyre, e të mos presim deri të bëhet iniciimi i plotësim-ndryshimit të ligjit dhe ta zgjedhim, ta aprovojmë të paktën, të mundohet në këtë rast Kuvendi.

Nuk di deri ku është shkuar me procedura, por e di se ne si Komision e kemi bërë kërkesën që të iniciohet edhe një herë procedura e prokurimit për zgjedhjen e auditorëve në harmonizim me këtë ligj për auditimin e subjekteve politike.

Në të kundërtën, edhe nëse zgjedhen, konsideroj të iniciohet plotësim-ndryshimi i këtij ligji, sepse ky ligj ka konfuzitet jo vetëm te neni 19 por edhe te nenet tjera, por nuk po dua të dal jashtë fushës për të cilën jemi takuar.

Unë edhe një herë ju falënderoj për ftesën dhe ju përsëndes të gjithëve për pjesëmarrjen.

**KRYETARJA:** Faleminderit, zoti Beqa. Fjala është për deputeten Synavere Rysha.

**SANAVERE RYSHA:** Faleminderit kryesuese e takimit!

Përsëndetje për të gjithë të pranishmit!

Tash Ligji për financimin e subjekteve politike është domosdoshmëri për ndryshim, nga arsyeja jo se ka qenë tepër i keq, dhe po duket këtu se pjesa e auditimit është çështja më e ndjeshme apo çështja që më së shumti ka nevojë të ndryshohet.

Unë them që nga fillimi, nga ligji i parë dhe plotësim-ndryshimet që kanë ndodhur, nuk ka qenë edhe tepër keq e rregulluar çështja e auditimit. Në një mënyrë është munduar t'i përshtatet rrethanave në Kosovë, por ndoshta ka qenë realitet se në Kosovë ka pasur më pak auditorë, dhe një përvojë e tillë ka qenë se një praktikë e tillë ka munguar në Kosovë dhe thjeshtë ka pasur rezerva për t'iu qasur, sidomos të partive politike.

Unë po e përmendi këtu, duke qenë pjesë e Komisionit për mbikëqyrjen e financave në këtë mandat sidomos përpjekjet e vitit 2016, që Komisioni ynë ka formuar edhe nën-komision dhe ka pasur edhe anëtarë nga Komisioni ynë për ta ndihmuar sekretarinë e Kuvendit dhe ta bëjë rizgjedhjen e auditorëve për auditimin e financave të partive politike.

Ndoshta problemi ka qenë te çështja financiare, pak edhe pse s'është kompani, por ne kemi provuar të formojmë standarde nga 10 auditorë të ndryshëm për ta bërë shpërndarjen në 3 – 3 – 3 dhe pastaj njëri prej tyre ta udhëheqë këtë proces, sepse është dashur të shkohet me standarde.

Pra, ajo që ka qenë problemi kryesor dhe që unë e kam parë personalisht, që e përmendi edhe Dreni në veten e parë, tha unë kisha pasur frikë me ua adituar partitë politike.

Po them se auditorët kanë hezitur për t'ia adituar partitë politike, prandaj nëse mundohemi të fajësojmë një parti dhe ta shfajësojmë një tjetër është tepër gabim, dhe sinqerisht këtë po them nga ajo që unë kam parë në vitin 2016. Mirëpo, problemi ka qenë se edhe auditorë që kanë qenë të licencuar për të hyrë në procesin e konkurrimit, kur i kanë parë specifikat, janë arsyetuar se janë financat e vogla, meqë u ka ardhur keq të thonë thjeshtë – është çështje pak e ndjeshme.

Prandaj, nuk ka kuptim t'ia hedhim fajin njëri – tjetrit, por të jemi realistë dhe të jemi të sinqertë. Unë këtë e kam parë nga viti i kaluar.

E tash, për të mos ju lodhë nga ajo pjesa çka kemi bërë, e që s'ka edhe shumë rëndësi, është me rëndësi qysh me bë tash në ligjin e ri, sepse patjetër duhet ndryshuar.

Pati vlerësime se duhet ta bëjë antikorrupsioni. Unë mendoj se Agjencioni Antikorrupsion nuk është më mirë i duhur për ta bërë këtë punë.

Arsyeja e vetme është sepse ata në fund, nga ai raport i prodhuar, do të nxjerrin diçka dhe ndoshta do të jenë edhe subjektet apo individët e caktuar dhe nga ai raport do të jenë në procedura penale, apo thjeshtë edhe produkt i atij raporti dhe do t'i shërbejë Zyrës Antikorrupsion. Dhe nga kjo, nuk ka kuptim që një njësi brenda asaj të antikorrupsionit tash mund të mendojë dikush se është ndikuar, prandaj nga ky fakt nuk është shumë e qëlluar të jetë antikorrupsion.

Tjetra ishte nga Zyra Kombëtare e Auditimit për çka prapë jam më shumë kah kjo, por edhe këtu e kam rezervën time. Pse? Sepse pjesa që financohet nga buxheti ekskluzivisht i takon Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe nuk kemi çka të themi, sepse fillimisht thotë – auditori auditon të gjitha kompanitë – subjektet që marrin fonde publike, dhe njëkohësisht edhe partitë politike marrin fonde publike. Por çfarë do të ndodhë me ato donacione dhe pjesë tjera që në njëfarë mënyre pastaj e implikon pak më ndryshe auditorin e përgjithshëm dhe ata duhet të ndalen, sepse nuk ka kuptim që një raport i audituar të jetë i përgjysmuar.

Mendoj se institucioni më i qëlluar dhe më adekuat është KQZ-ja, sepse KQZ-ja ndanë fonde dhe KQZ-ja duhet t'i auditojë. Prandaj, nëse këta arsyetohen se nuk duhet në KQZ, mendoj se e kanë gabim. Por, nëse s'donë ta bëjnë, është çështje e tyre.

Prandaj, ne si deputetë duhet bërë përpjekje që ta trajtojmë mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'ia gjejmë vendin adekuat.

KQZ-ja, nëse nuk ka kapacitete dhe faktikisht nuk ka, meqë është auditim i jashtëm, duhet zgjedhur një kompani nëse jo vendore, të themi decidivisht në ligj, kompani ndërkombëtare. Dhe, pse jo? Dhe ajo jo me 10 auditorë por le të vjen me 20 auditorë, dhe fondi pastaj nuk do të ketë shumë rëndësi, sepse ne e kemi edhe nëpër raporte të ndryshme ndërkombëtare, e kemi temë debatin në Kosovë, nuk ka rëndësi tash sa mjete shkojnë por e rëndësishme është të kemi raporte të besueshme nga partitë politike.

Prandaj, nga kjo peshë, mendoj se, nëse ka nevojë për rishikim, t'i japim fonde shtesë KQZ-së, por ky auditim ndodhë në vitin 2016.

Unë vazhdimisht do të mundohem t'i përkrahi gjatë amendamentimit, por kjo është për fillim. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit zonja deputete! Fjalën e kanë, së pari ata të pranishmit, dhe ata që e kanë kërkuar për të dytën herë, e marrin fjalën pas këtyre që e kanë kërkuar për të parën herë. Zoti Fehmi Pireva, e pastaj Enis Halimi, nga KQZ dhe vazhdomë tutje me zotin Mayer nga NDP dhe deputetin Enver Hoti, që e kërkon fjalën për të dytën herë.

**FEHMI PIREVA:** Faleminderit!

Në formë të përmbledhur do të përpiqem të jap një kontribut modest, sepse kam qenë disa vite me punë në Zyrën për Regjistrim dhe Certifikimin e Partive Politike dhe një kontribut individual, kam bërë përpjekje ta jap nëpërmes një libri në këtë fushë, i publikuar në vitin 2012.

Pra, rreth kësaj tematike do të përpiqem që në 5-6 pika, ta rrumbullakësoj debatin për të mos u marrë kohë tjerëve.

E para, mendoj se ka nevojë të zgjerohet e strukturohet debati lidhur me këtë temë, për të cilën jemi mbledhur sot;

E dyta, ka nevojë që nga këto takime, debate e tryeza të krijohet një koncept-dokument me rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike;

Nën tre, të identifikohen dispozitat ligjore që do t'i nënshtrohen shqyrtimit të ndryshimit dhe plotësimit të ligjit;

Nën katër, adresimi i përgjegjësive për subjektin, i cili do të jetë bartës ose kompetent për auditimin e raporteve të subjekteve politike,

Nën pesë, ta kemi një pasqyrë të përvojave nga vendet e rajonit, që ngjajnë me specifikat ligjore kushtetuese, sistemin zgjedhor, performancat e treguara në fushat e auditimit nga institucionet kompetente,

Nën gjashtë, nxjerrja e një ligji që do të kishte kohezion për një periudhë më të gjatë të zbatueshmërisë, sepse ky ligj i është nënshtruar dy herë ndryshim – plotësimit.

Dhe së fundi, një pyetje për të cilën nuk kemi marrë përgjigje nga auditorët ose zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit :

- Pse për Zyrën Kombëtare të Auditimit nuk bën të bëhet auditimi i donacioneve (të dhëna nga individët, subjektet afariste) për subjektet politike, kurse bënë për KQZ-në dhe për Kuvendin?

Unë kam mbetur pa përgjigje!

Dhe, nëse Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion publik, njësoj është edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Urdhëroni ju zoti Halimi, pastaj përfaqësuesi nga Zyra e Auditorit, e pastaj vazhdojmë tutje.

HALIMI... Faleminderit! E mora fjalën ndër të fundit dhe ndoshta rrezikoj të përsëris diçka, por megjithatë do t'i citoj sa për korrektësi.

Nëse flasim për motivet dhe arsyet se pse nuk është bërë auditimi nga Kuvendi i Kosovës? Bartja e një procesi në mënyrë teknike prej Kuvendit të KQZ-ja do të ballafaqojë KQZ-në me të njëjta probleme e motive që ka dështuar edhe Kuvendi i Kosovës për ta proceduar këtë punë.

Pra, ky është rrafshi teknik dhe ne po e bëjmë një bartje nga një institucion në një tjetër, që ka qenë dhe nuk është treguar efektiv as atëherë e as tash me Kuvendin.

Më pëlqyen dy ide, ndoshta të deputetit Ali Sadriu dhe Bardhosh Aliu, e ndoshta edhe të zotri Cacajt, që ose Kuvendi të ngrisë stafin e vet nga brenda dhe të formësojë një trupë e cila do të procedonte me këtë aktivitet, apo që subjektet të marrin atë cilësimin që e përmendi edhe zoti Cacaj se prej atij momenti auditohen sikur ata që marrin para publike dhe e fitojnë subjektivitetin.

Pra, jemi këtu në rrafshin substancial dhe ky është ndryshim konceptual dhe rrafshi teknik apo aspekti teknik bartës prej një institucioni në tjetrin, por problemet dhe motivet për të cilat kanë dështuar do të vazhdojnë të na përcjellin edhe neve. Nuk kemi ne kundër, sepse tek e fundit ju jeni organi vendimmarrës dhe ne s'kemi edhe çka të bëjmë për atë punë, por puna është që nuk zgjidhim kurrëgjë. Pra, nuk zgjidhim por vetëm e bartim një problem prej një institucioni në institucion tjetër

dhe ndoshta më të vogël e me më pak mundësi dhe që ndoshta nuk është krejt në domenin e qëllimit të ekzistencës së tij. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit! Sa herë që kryetarja e KQZ-së ka raportuar në Komisionin për Legjislacion ajo ka kërkuar që t'i hiqet së pari kompetenca KQZ-së. Do të thotë e kanë kundërshtuar në vazhdimësi dhe unë e përkrahi këtë qëndrim, mirëpo patjetër duhet të bëjmë një zgjidhje në qoftë se kjo kompetencë nuk kalon prapë te KQZ-ja.

Fjala është për përfaqësuesin e Zyrës së Auditorit, por ju lus të prezantoheni!

**IMRI SEMETISHTI:** Një nga parafolësit e sqaroi shumë saktë mandatin kushtetues të Zyrës Kombëtare dhe në fakt mandati kushtetues nuk i mundëson aktualisht Zyrës Kombëtare që të merret me auditimin e financave publike.

Një dilemë tjetër, që e ngriti dikush...

(Ndërhyrje)

Më fal, të partive politike. Pra, çështja e profesionit na ka futur në organe publike.

Kushtetuta nuk e mundëson mandatin e Zyrës Kombëtare që t'i auditojë financat e subjekteve politike.

Tash, besoj e thashë saktë, a?

Një ndërlidhje tjetër në Ligjin e menaxhimit të financave publike. Është shumë e vërtetë se ky ligj thotë se auditohen të gjitha financat publike, e ky ligj thotë edhe diçka tjetër – të gjitha financat publike duhet të shpenzohen në përputhje edhe me procedurat përkatëse në institucionet publike që e zbatojnë këtë ligj. Në përputhje me këtë ligj, pra të menaxhimit të financave publike janë zhvilluar edhe standardet e auditimit për financa publike.

Subjektet politike nuk i shpenzojnë financat sipas këtyre procedurave të Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe përveç problemit ligjor, kjo konsiston edhe në problemin praktik që e pamundëson auditimin e financave të subjekteve politike.



Përveç kësaj, në vendet e rajonit ka zgjidhje të ndryshme. Në disa shtete kanë që zyrat kombëtare të auditimit apo institucionet më të larta të auditimit i auditojnë financat e subjekteve politike.

Realisht, në komunikim me këto zyra, vërehet se këto gradualisht e kanë humbur besimin dhe kredibilitetin në publik.

Vetë natyra e auditimit të financave të subjekteve politike, i sjell në një situatë që i bëjnë jo shumë kredibile e të besueshme edhe në raport me auditimin e financave të organizatave buxhetore pastaj. Dhe kjo praktikë, do të duhej të ndryshohet.

Si përfundim, tendenca për të kaluar auditimin e subjekteve politike në Zyrën Kombëtare konsiston në një ndryshim esencial, që nga Kushtetuta, Ligji mbi menaxhimin e financave publike, por edhe nga zhvillimi i një kornize rreth modelit apo formatit të raportimit financiar nga vetë subjektet politike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit zoti Semetishta! Fjalën e ka zoti Mayer, pastaj deputeti Hoti!

**MAYER...**

**(Diskutimi në anglisht)**

KRYETARJA: Faleminderit zoti Mayer! Fjalën e ka deputeti Hoti, pastaj deputetja Synavere Rysha, dhe pastaj do ta përmbyllim.

ENVER HOTI: Faleminderit kryetare!

Ju kërkohet falje të gjithëve që e mora fjalën për së dyti. Vërtet u diskutua dhe u kalua për të mos u kaluar si në heshtje.

Dy çështje, një të ngriti zoti Sadriu lidhur me auditimin në atë formë, pasi jeni këtu, të blerë nga agjencionet e pavarura dhe ajo që u shfaq si mundësi e frikës së auditimit të partive politike, mendoje është një shqetësim tani tjetër, është një dilemë tjetër dhe neve na qet në një situatë krejtësisht tjetër.

Nëse ne kemi arritur si vend që dikush të frikohet për t'i audituar partitë politike, atëherë vërtet i kemi punët keq.

Dhe nëse qe 4 vite nuk jemi audituar dhe nëse kjo trashet akoma më tutje, ky mosauditim, atëherë shtrohet dilema – kush janë ato parti politike? Janë parti formale, janë parti të ditës apo janë parti joformale dhe të natës, të cilët njerëzit nuk guxojnë t'i auditojnë.

Kjo dilemë për mua është një alarm dhe ajo që dëgjova nga disa deputetë, siç u tha edhe nga një organizatë, një përfaqësues i një OJQ-je, edhe nëpër retorikën ose nëpërmjet fjalës së një deputeti u dëgjua se mund të ketë edhe dilemë të tillë, për mua është alarm. Faleminderit!

**KRYETARJA:** Faleminderit zoti Hoti! Deputetja Rysha e ka fjalën!

**SYNAVERE RYSHA:** Tashmë, në realitetin e Kosovës, jetojmë të gjithë dhe e dimë si është.

Unë thashë, kanë hezituuar, asgjë më shumë. Sidoqoftë, përfaqësuesi nga Kuvendi tha pse mund të bëjë Kuvendi auditimin, mund ta bëjë edhe KQZ-ja, por nuk mund Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pse nuk mund ta bëjë Zyra Kombëtare e Auditimit, e tha vetë përfaqësuesi nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe e thashë në diskutimin e parë, nuk po e përsëris e as lodhi.

Po pse mund ta bëjnë KQZ-ja ose Kuvendi, që mendoj prapë KQZ-ja sepse i mban fondet dhe duhet t'i auditojë fondet, mund ta bënë sepse ata nuk e bëjnë vetë, por e bëjnë nga kompanitë e jashtme audituese. Do të thotë, e bëjnë përmes formës së prokurimit, prandaj kjo është arsyeja pse ata mund ta bëjnë, e Zyra Kombëtare e Auditimit nuk mund ta bëjë.

Ndërsa, formimi i një trupi apo grupi të auditorëve brenda Kuvendit, mendoj se është gabim. Për auditim të brendshëm nuk po flasim ne. Po flasim për auditim të jashtëm dhe nëse bëjmë auditorë të jashtëm brenda Kuvendit, ne po i krijojmë dy sisteme paralele, sepse e kemi ZKA-n – Zyrën Kombëtare të Auditimit, dhe si me bë edhe një zyre tjetër brenda Kuvendit?

Prandaj, për mendimin tim, prapë KQZ-ja është vendi adekuat, ku duhet të bëhet. Dhe për modalitetet, ne prapë e hulumtojmë dhe punojmë në këtë drejtim për të pa si do të bëhet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit zonja Rysha! Vetëm një përmbyllje. Së pari, ju falënderoj të gjithëve për kontributin që e keni dhënë në këtë tryezë. Besoj se do të janë jashtëzakonisht të vlefshme diskutimet të cilat i kemi pasur këtu.

Prej asaj që u tha, pashë një hezitim të institucioneve qoftë të Zyrës së Auditorit, qoftë të KQZ-së për ta bartur këtë kompetencë te këto institucione.

U tha këtu që të lihet me propozime kështu siç është, por të shtohet buxheti në këtë drejtim.

Pastaj, u dhanë propozime që kjo çështje të bartet te KQZ-ja. Ishte propozimi, e ndoshta vetëm si qëndrim dhe jo propozim që këtë çështje ta ketë edhe Agjencioni Kundër Korrupsionit, dhe pastaj, propozimi tjetër te Zyra e Auditorit.

Pra, ishin disa prej propozimeve të cilat, nuk është se nuk i kemi dëgjuar, por megjithatë Dreni e pati një propozim, e po ashtu ishte edhe nga NDP që të formohet një grup punues nga 3 komisionet parlamentare siç është Legjislacioni, Buxheti dhe Financat Publike.

Njëherit po ju kërkoj ndjesë në emër të dy kryetarëve të cilët u deshtë t'i lirojmë më përpara për shkak të angazhimeve të tyre.

Dhe ne si Komision për legjislacion meqë e kemi organizuar këtë tryezë, do ta përpilojmë një përmbledhje të këtij diskutimi dhe me atë përmbledhje do të dalin edhe rekomandimet të cilat i potencova dhe do ta shpërndajmë edhe te komisionet tjera, por pse jo edhe te ju, në mënyrë që sa më parë e sa më shpejt të dakordohemi për formimin e një grupi punues i cili do të jetë përgjegjës për propozimet, në mënyrë që kjo çështje njëherë e përgjithmonë të adresohet.

Ju falënderoj edhe një herë, dhe shihemi në takimet tjera!